

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7730 E enjte 6 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**Q**everia të lërë mënjanë demagogjinë me tarifat dhe të marrë përgjegjësinë. Para këtij miratimi të ligjit të ri në vitin 2015, tarifat i propozonin...

Vijon në faqen 20

Nga SHEZAI RROKAJ

5 për qind e PBB përkrahje për arsimin, pse s'u mbajt premtimi?



Opinion

Ditës

**H**istoriani i ndjerë Erik Hobsbaum, e përshkroi shekullin XX si "epoka e ekstremeve", në të cilën socializmi shtetëror krijoi gulagët; kapitalizmi liberal ...

Vijon në faqen 21

Nga SHLOMO BEN-AMI

Konflikti global, në një epokë të re të ekstremeve



"Dorëzoni llogarinë bankare dhe kopjen e ID"

## Trashëgimtarët e të përndjekurve, emrat që marrin dëmshpërblimin

Lista e plotë, kush janë përfituesit e kështit të tretë të dëmshpërblimit

Ministria e Financave ka publikuar listën emërore të trashëgimtarëve të ish-të përndjekurve politikë, të cilët duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë bankare dhe një fotokopje karte identiteti ose pasaportë, në mënyrë që të marrin paratë e dëmshpërblimit. Për ata që kanë një llogari aktive bankare dhe e kanë dorëzuar ...

Në faqen 18-19

SHPERTHEN REAGIMI TE MINISTRIA SE ARSIMIT, TE RINJTE BLOKOJNE RRUGET

## STUDENTET NE PROTESTE: TE ULEN TARIFAT E UNIVERSITETIT

Reagon Edi Rama: Nuk shpenzojmë paratë e taksave për ngelësit. Lindita Nikolla: Tarifat nuk i përcakton qeveria, universitetet kanë autonomi



(Në foto) Protesta e studentëve para Ministrisë së Arsimit

Në faqen 2-3

NISMA E OPOZITES

Vetingu, Komisioni i Venecias: Qëllim i mirë, por një mekanizëm i gabuar

Në faqen 6-7

MISTERI

Dibër, zhduket nipi i ish-shefit të komisaritit, të afërmit: Dyshimi ynë

Në faqen 9

BANORET NE RRUGE

Protesta tek Unaza e Re, Basha: Duhet të rezistoni, do ta fitojmë betejën


Në faqen 4-5

MINISTRIA E KULTURES

Lahuta regjistrohet si serbe në UNESCO, qeveria: I përket të gjithë rajonit

Në faqen 17

ZARFI I ÇUDITSEM



Plumb në Galerinë e Arteve, denoncim në polici artistit Armando Lulaj

Në faqen 17

Analisti shqiptar që jeton në SHBA, Agron Alibali: Joni, det i paqes

## "Pakti detar", 'Luarasi' leksion i hapur me ekspertë

"Universiteti ruan traditën e fuqishme të cilësisë dhe profesionalizmit"

Nga VOLTIZA DURO

**N**ë kuadër të kombinimit të teorisë me praktikën, universiteti "Luarasi" vijon traditën e leksioneve të hapura të zhvilluara nga ekspertët më të mirë në vend e më gjërë. Këtë të mërkurë, analisti shqiptaro-amerikan i çështjeve



ballkanike, Agron Alibali mbajti leksionin me temë "Deti Jon si det i paqes dhe delimitimi i hapësirave detare me Greqinë". Vetë studentët e Fakultetit të Drejtësisë në "Luarasi" shfaqën interes për çështjen e diskutuar me ekspertin për paktin detar dhe ...

Në faqen 11

## PROTESTA E STUDENTEVE REAGIMET

Studentët, sot sërisht para MASR: Bojkotim mësimi deri në plotësimin e kërkesave

# Protestë masive e studentëve para Ministrit të Arsimit kundër tarifave

*"Qeveria t'i thërrasë mendjes, kërkojmë të drejtat"*

Voltiza Duro

Qindra studentë të universiteteve publike në vend kanë protestuar dhe kundër tarifës prej 670 lekësh për kredit për provimet e mbartura. Nën sloganet "Anulo vendimin", "Jemi studentë, jo klientë", "Ne nuk ikim" studentët kanë marshuar drejt Ministrisë së Arsimit ku në shenjë revolte kanë hedhur vezë, stilolapsa e letra në drejtim të këtij institucioni. "Po protestojmë kundër vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288 që nuk është botuar në fletoren zyrtare në maj të këtij viti dhe është miratuar në mënyrë të fshehtë për të na i bërë surprizë në fundvit. Kjo është e padrejtë dhe e paarsyeshme, pasi i gjobit studentët, është një gjobë e pastër, e në vend që t'i nxisë studentët të mbarojnë shkollën, i nxit që ta braktisin atë. Çmimi i kreditit prej 670 lekësh është çmenduri për kushtet ekonomike dhe fuqinë paguese të studentëve. Ministria që po na rrjep edhe qindarkat e fundit bën mirë t'i vejë gishtin kokës sa të mos jetë shumë vonë", thotë studenti Klodi Leka. Ditën e sotme studentët do të protestojnë sërisht para MASR deri në plotësimin e të gjitha kërkesave "Nesër (sot) në orën 8.00 të mëngjesit studentët e të gjitha universiteteve publike do të bojkotojnë sërisht mësimin duke u grumbulluar në oborret e fakulteteve përkatëse për të marshuar drejt Ministrisë së Arsimit. Në orën 10.00 protestojmë përpara ministrit deri në plotësimin e të gjitha kërkesave!", thonë studentët për "GSH".

### KËRKESAT

Përveç anulimit të VKM që i detyron të paguajnë 670 lekë për kredit për çdo provim të mbartur, studentët kanë kërkuar edhe përgjysmim të tarifave në institucionet publike, si dhe përmirësim të kushteve të jetesës në konvikte. Pavarësisht tentativës së zëvendësministres së Arsimit Besa Shahini për të ne-

gociuar me studentët, këta të fundit e përzunë nga tubimi duke thënë se nuk bëhen pjesë e shantazheve dhe premtimëve boshë. "Kërkesat tona janë: anulimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288 të miratuar më datë 21.05.2018 sidomos pikës 4 që

i vendos një gjobë studentëve për provimet e mbartura; rritjen e buxhetit të shtetit për universitetet publike; përgjysmim të të gjitha tarifave universitare. Ndërsa nga autoritetet e drejtuesve kërkojmë: ndarjen e pagesës së tarifës në këste;

shtyrjen e afatit të pagesës së secilit këst përtej sezonit të provimeve të semestrit të parë", thekson një prej studentëve për Gazeta Shqiptare. Lidhur me reagimin e kryeministrit Edi Rama i cili u shpreh se tatimpaguesit nuk duhet të paguajnë për ngelësit, studentët shprehën se kjo ndodh pasi punojnë për të paguar shkollën. "Ne jemi ngelës se ju na keni detyruar të punojmë si qeni për të paguar tarifat e papërbalueshme", thotë A.Ç njëra prej studentëve. Më tej ata thonë se nuk iu bënë përshlyesje asnjë reagim i Ramës e se nuk do të ndalen. "Studentët ju përgjigjen Ramës me thirrjet e tyre. Nuk na bëjnë më përshlyesje këto reagime të kryeministrit në do të protestojmë deri sa Qeveria t'i thërrasë mendjes se këto që po kërkojmë janë të drejta dhe jo utopi", thotë studentja Arbiona Çibuku për "GSH".



Protesta e djeshme e studentëve

### KËRKESAT E STUDENTEVE JANË:

1. Anulimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288 të miratuar më datë 21.05.2018 sidomos pikës 4 që i vendos një gjobë studentëve për provimet e mbartura.
  2. Rritjen e buxhetit të shtetit për universitetet publike
  3. Përgjysmim të të gjitha tarifave universitare.
- Nga autoritetet e drejtuesve kërkojmë:
1. Ndarjen e pagesës së tarifës në këste
  2. Shtyrjen e afatit të pagesës së secilit këst përtej sezonit të provimeve të semestrit të parë.

## Pedagogu: Protesta do të vijojë

# Arlind Qori: Rama dhe Nikolla kanë humbur autoritetin moral



Pedagogu Arlind Qori

Pedagogu Arlind Qori, i pyetur nga Gazeta Shqiptare tregon se bojkoti i mësimi do të vazhdojë dhe thekson se ministria Nikolla dhe kryeministri Rama e kanë humbur autoritetin moral. "Studentët protestues të ditës së sotme vendosën bashkërisht që protesta të vazhdojë nesër (sot) në mëngjes. Pritet që në të gjitha universitetet publike të bojkotohet mësimi dhe, paskëta, studentët të bashkohen përpara Ministrisë së Arsimit. Kryeministri Rama dhe ministria Nikolla e kanë humbur autoritetin moral. Që në fillim të qeverisjes së tyre, kur gatuan një ligj arsimit të lartë kryekëput klientist, askush nuk u beson më se qeverisin për të mirën publike dhe atë të universiteteve", thotë pedagogu për "GSH". Ky i fundit ndalet edhe te pagesa e tarifës së krediteve për provimet e mbartura. "Ko-

hët e fundit qeveritarët kanë humbur edhe arsyen. Pa pikën e kuptimit kanë vendosur një gjobë të rëndë, ku secilit student do t'i duhet të paguajë mijëra lekë shtesë për çdo provim të mbartur. E dini ç'kosto shtesë i sjellin universitetit ata? Dy fletë të

studimeve, ajo ka zgjedhur t'i tarifojë akoma edhe më shumë. Nga ana tjetër, Rama dhe Nikolla duken se nuk arrijnë të mendojnë as sa një nxënës i klasës së parë. Studentët kërkojnë me ngulm uljen e tarifave pasi për shumë prej tyre ato janë të papërbalueshme. Kurse qeveritarët i përgjigjen kërkesës së tyre duke thënë se nuk i kemi rritur që nga viti 2014!!!! Edhe sipas ligjit të arsimit të lartë, qeveria ka në dorë nivelin e financimit të universiteteve publike dhe përcaktimin e tarifës maksimale. Mjafton të rrisë buxhetin e shtetit për universitetet publike dhe të ulë tavanin e tarifës maksimale", shton Qori për "GSH".

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHIL.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llika Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrafikëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel:Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk





#### VASIL: PO RRJEPIN STUDENTËT

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasil thotë se kryeministri Edi Rama grabit miliona me koncesione dhe u kërkon para studenteve. "Rama rrjep paratë e u kërkon gjakun studentëve, turp e faqe e zezë e këtij që plaçkit studentët", - thekson Vasil.



#### PALOKA: TA SHPORRIM QELBËSIRËN

"Pas 'shpëlarëve', 'shpazëve', 'malokëve', 'kazanit', 'talebaneve', tani dhe 'ngelësit'! Dikur Rama u bëri thirrje e bashkoi të gjithë qelbësirat për ta çuar në pushtet. Sot është koha të bashkohen të gjithë shqiptarët e ndershëm e hallexhinj për të shporrur qelbësirën", - thotë Edi Paloka.



#### NISHANI: JENI E NESËRMJA

"Sot, studentët duhet t'u bëjnë thirrje pedagogëve që t'i bashkohen lëvizjes së tyre. Atyre pedagogëve që nuk janë zhytur e përlënyer në tepsinë e çorbës së hajdutërisë e zhvatjes. Sot, lëvizja e tyre është destinacioni i të nesërmes për të gjithë!", - thekson ish-presidenti Bujar Nishani.



#### TABAKU: REFORMA OGURZEZË

"Mëma e të këqijave sot është Reforma e Arsimit që prodhon ndër të tjera edhe rritje tarifash për studentët. Kjo reformë që ogurzezë për studentët dhe ndonëse opozita e kundërshtoi dhe replikoi ashpër me qeverinë, sërishmi kokëfortësia dhe makutëria e mazhorancës fitoi" - tha Tabaku.



"I kemi thirrur në takim, por nuk kanë pranuar të vijnë për diskutime me MASR"

## Ministria Nikolla: Studentë, duhet të njihni ligjin

"Tarifat përcaktohen nga universitetet, s'ka rritje"

#### NIKOLLA

"Me shumë të drejtë kërkojnë kushte gjithnjë e më të mira në konvikte, jemi të vendosur të adresojmë projekte investuese në Qytetin Studenti dhe në vende të tjera. Në Tiranë janë investuar 5.3 mln euro në 4 godina studentësh të Inxhinieria dhe janë në investim nga KfW edhe 6 mln euro për 8 godina në Qytet Studenti".



**Rama: Tatimpaguesit nuk duhet të shpenzojnë për studentët ngelës**

Pas protestës së qindra studentëve ditën e djeshme, edhe kryeministri i vendit, Edi Rama ka reaguar mbi detyrimin e pagesës së tarifave për provimet e mbartura. Kreu i qeverisë thekson se tarifat përcaktohen nga universitetet dhe jo nga ministria, ndërkohë që shton se VKM për tarifat e mbetësve është kërkuar nga universitetet. Rama bën me dije se prej vitit 2014, nuk ka pasur asnjë rritje tarifash nëpër universitete. "Thjesht e vërteta: 1. Tarifat s'i përcakton ministria po universiteti 2. Asnjë tarifë s'është rritur nga 2014 3. VKM për tarifat e mbetësve është kërkuar nga universitetet 4. Efekti i VKM nis vitin tjetër 5. Ministria u ka sugjeruar sot universiteteve të konsiderojnë rishikimin e VKM. A jeni ju dakord që t'i paguani ju, pra taksapaguesit, shpenzimet e universitetit për studentët ngelës? Unë për vete nuk jam dakord", thekson kryeministri i vendit.

#### Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e dytë, për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme, por të cilat ka vënë hipoteke NIBG Bank/ABI BANK, me këto të dhëna: Llogji njësi me sip. 189 m<sup>2</sup> nr pasurie 5/188Ind-n1, zk.8350 vol 28 fq.146 RR.PM.Yezariq TIRANË në pronësi të Z.Ajlan Rahmi BAHOLLI. Çmimi me të cilin fillon shëllja në ankand është 179.760 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë) EUR. Llogji apartament sip.132m<sup>2</sup> zk.8350 nr pas.5/188Ind-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANË në pronësi të Z.Ajlan Rahmi BAHOLLI. Çmimi me të cilin fillon shëllja në ankand është 73.920 (shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë) EUR. Ankand i zhvillohet në datën 08.01.2019, në përfaqësim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartësve gjyqësor, me adresë: Bulevardi Bajam Curri, Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijusticia.com, tel. +355 4 2270890

#### Voltiza Duro

Lidhur me protestën e qindra studentëve, mesditën e djeshme, ministria e Arsimit Lindita Nikolla, ka dalë në një konferencë për mediat për të sqaruar situatën. Ajo ka theksuar se është e gatshme të dëgjojë zërin e studentëve dhe ka marrë në dorë kërkesat e tyre, e madje ka bërë me dije se nuk ka rritje tarifash. "Ka ardhur koha që të gjithë të mësojnë të vërtetën se çfarë ka ndodhur me tarifat. Nga 2009-2013, nuk po i referohem vitit 2005, se rritja është edhe më e thellë. Në 2013-2017 kemi rritje vetëm në vitin 2014 të tarifës maksimale. Kjo rritje nuk ka prekur gjithë programet e studimit, ka prekur vetëm shkencat e natyrës dhe gjuhët e huaja. Efekti financiar, 75 mln lekë. Ishte vendimarrje në kohën e duhur, pasi në 2014 bëmë një ndërhyrje në arsimin e lartë, duke moskuotuar më parttime, i cili është një histori më vetë. Ndaj nuk mund të lejojmë një grëpë financiare tjetër. Një 5570 lekësh në vit, kjo është rritja, se sa fish është të gjithë i bëni vetë llogaritë. Dhe deri më sot në 4 vite, nuk kemi asnjë rritje tarifash studi. Vendimarrja nuk ka paraparë rritjen e tarifave. Ligji i ri i jep qeverisë të drejtë vetëm për tarifat tavan, të tjerat janë kompetencë e fakulteteve", theksoi ministria.



Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla

#### trja Nikolla në fjalën e saj. PËRGJYSMIMI I TARIFAVE

Për sa i përket kërkesës për përgjysmim të tarifave, ministria Lindita Nikolla kërkoi nga studentët të njohin ligjin. Ajo më tej la të hapur për diskutim pagesën e tarifave për provimet e mbartura. "Janë universitetet që vendosin për tarifat. Për të kaluar në atë që është kërkesë e parë, të shqetësimi i studentëve; anulimin e VKM, pikën 4. Këtu kam dy VKM, atë të vitit 2013, që thotë se studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi. Ndaj kjo është e njëjtë dhe tashmë. Për të gjithë ata student, e

përsërit me respektin maksimal se janë në të drejtën e tyre të protestojnë, ai nuk ka hyrë në fuqi për këtë vit. Jam e hapur që të mbledhet Këshilli i Ministrave që kjo pikë të diskutohet nga universitetet. Jam e gatshme që të gjendet një zgjidhje për këtë pikë", tha Nikolla. Ndërkohë ministria më tej u ndal edhe te përmirësimi i kushteve të konvikteve. "Me shumë të drejtë kërkojnë kushte gjithnjë e më të mira në konvikte, jemi të vendosur të adresojmë projekte investuese në Qytetin Studenti dhe në vende të tjera. Në Tiranë janë investuar 5.3 mln euro në 4 godina studentësh të Inxhinieria,

#### TARIFAT

Dhe deri më sot në 4 vite, nuk kemi asnjë rritje tarifash studi. Vendimarrja nuk ka paraparë rritjen e tarifave. Ligji i ri i jep qeverisë të drejtë vetëm për tarifat tavan, të tjerat janë kompetencë e fakulteteve", theksoi ministria Nikolla në fjalën e saj.

dhe janë në investim nga KfW edhe 6 mln euro për 8 godina në Qytet Studenti.

#### THIRRJA PËR DISKUTIM

Në konferencën e saj për mediat, ministria e Arsimit, Lindita Nikolla tha se iu ka kërkuar studentëve të ulen së bashku në diskutime, por ata nuk kanë pranuar. "U bëra me dije dekanëve dhe Rektorëve për një protestë të një grupimi studentësh. U kam kërkuar studentëve që të komunikojë me ta për të ndarë të gjitha shqetësimet që ata kishin. Nuk kanë pranuar që të vijonim në këtë rrugë. Kanë dashur një takim informal me zv/ministren. Ata janë një pasuri e kombit tonë. Ndaj ata nuk meritojnë që të mos dëgohen dhe meritojnë që t'u përgjigjesh në zyrën e ministres dhe në aulat e tjera. Më pas studentët kanë adresuar, drejt ministrisë së arsimit një kërkesë që unë po e lexoj", tha ministria.

## UNAZA E MADHE PROTESTA

Rama nxjerr videon me punimet tek Unaza e Madhe dhe uron ditë të mbarë

# Banorët me jelekë portokalli ulen në tokë: Nuk mposhtemi

Deputetët e PD-së tek "Astiri", Bregu i Lumit dhe Shkozë

Valentina Madani

Banorët e "Astirit" bllokuan sërish dhe rrugën në ditën e 32-të të protestës kundër prishjes së banesave të tyre. Qytetarët, banesat e të cilëve preken nga projekti i Unazës së Re kërkojnë dëmshpërblim me vlerën e tregut. Protesta u shoqërua me bilbilë, çakmakë të ndezur dhe thirrje të shumta kundër qeverisë. Të veshur me jelekë portokalli, banorët u ulën në tokë dhe bllokuan rrugën kryesore. Me thirrjet "O Edvin diarre, këtu i thonë Unaza e Re" dhe "O Edvin tradhtar do të tërheqim me litar", banorët hodhën akuza në drejtim të qeverisë dhe kryeministrit Rama. Në mbështetje të tyre ishin edhe deputetët të opozitës si dhe kreu i PD, Lulzim Basha. Protestat për banesat që do të shkatërrohen janë kthyer në aktivitetin kryesor të opozitës ditë e fundit. Deputetët demokratë kanë ikur nga Kuvendi dhe në mënyrë të organizuar janë gjendur në çdo protestë në Tiranë. Ndërkohë që banorët vijojnë protestën kundër shembjes së banesave që preken nga projekti i Unazës së Madhe, pa marrë më parë dëmshpërblimin për to, kryeministri Rama ka postuar sot një video nga ecuria e punimeve në këtë kantier. Ndërkohë që banorët vijojnë protestën kundër shembjes së banesave që preken nga projekti i Unazës së Madhe, pa marrë më parë dëmshpërblimin për to, kryeministri Rama postoi dje një video nga ecuria e punimeve në këtë kantier. "Mirëmëngjesi dhe me këto pamje nga puna që vijon në kantierin e Unazës së Madhe të Tiranës, në segmentin nga Farka drejt Shkozës, ju uroj një ditë të mbarë #RrugëtKomëtare #përShqipërinëQëDuan", - shkruan Rama. Posh-të videos nuk mungojnë komente e ndryshme nga ana e ndjekësve të tij në FB, shumë prej të cilëve e akuzojnë se po tallet, pasi para zgjedhjeve premtoi legalizim e pas tyre u shemb banesat. "Bravo,



Protesta e banorëve tek "Astiri"

### THIRRJET

Të veshur me jelekë portokalli, banorët janë ulur në tokë dhe kanë bllokuar rrugën kryesore. Me thirrjet "O Edvin diarre, këtu i thonë Unaza e Re" dhe "O Edvin tradhtar, do të tërheqim me litar" banorët kanë hedhur akuza në drejtim të qeverisë dhe kryeministrit Rama.

## Deputetët Tabaku e Balliu, te komisariati nr. 4

# Denoncimi i PD: Tre protestues u arrestuan padrejtësisht

Partia Demokratike de noncoi dje arrestimin pa asnjë letër të tre protestuesve, që u ngritën kundër shembjes së banesave të tyre. PD bën me dije se, "në mënyrë të befte dhe pa asnjë shkak real policia është shfaqur në dyert e pjesëmarrësve në protestë për mbrojtjen e shtëpive të tyre. Zotërinjtë Agim Peposhi, Lahi Lleshi dhe Fuat Durollari janë marrë në rajon pa asnjë letër nga policia e Partisë Socialiste, që nuk mbron rendin por sulmon qytetarët". Sipas PD, "pa asnjë shkak ato janë arrestuar, ndonëse protesta dje ka qenë tejet paqësore dhe konform rregullave ligjore. Ato arrestohen, sepse duan të mbrojnë shtëpitë e tyre, arrestohen sepse duan të mbrojnë liritë e tyre".



### PROTESTA

Zotërinjtë Agim Peposhi, Lahi Lleshi dhe Fuat Durollari janë marrë në rajon pa asnjë letër nga policia e Partisë Socialiste, që nuk mbron rendin por sulmon qytetarët. Sipas PD, "pa asnjë shkak ato janë arrestuar, ndonëse protesta dje ka qenë tejet paqësore dhe konform rregullave ligjore".

Ndërkohë në mbështetje të tyre, deputetët Jorida Tabaku dhe Klevis Balliu janë në komisariatin nr. 4. "Kjo situatë ndodhte vetëm

në diktaturë. Vetëm në komunizëm arrestoheshen se protestojnë kundër qeverisë. I duhet thënë boll!", - apelon PD.

"Ne jemi qytetarë, ti je shpellar", "Lironi vëllezërit tanë, poshtë kriminelët", "O Edvin, o zagar do të tërheqim me litar", këto janë disa nga thirrjet e qytetarëve. Banorët janë shprehur njëzëri se Rama ta harrojë se do mposhtë shqiptarët me rrugë të kundraligjshme.

Florjan Protoduari, një prej protestuesve deklaroi: "Këlyshi Rama mendon se jemi lodhur, do të mbrojmë shtëpitë tona, arritëm sot në ditën e 32-të të protestës. Dorin e mbajnë në burg, hajde më arrestoni mua, babanë e tij se unë e organizoj këtë protestë, hajde arresto-



Protesta e banorëve tek Unaza e Madhe



## Akademiku në protestë: As Enveri nuk u prishi çatinë fëmijëve

Akademiku Apollon Baçe iu bashkua dje banorëve të "Astirit" në ditën e 32-të të protestës së tyre në mbrojtje të banesave, ndërsa tha se ky projekt është një grabitje ndaj qytetarëve. Baçe ftoi qytetarët që të qëndrojnë të bashkuar, ndërsa tha se askush nuk ka guxuar që t'i prishë çatinë një fëmije, as diktatori Enver Hoxha. Baçe tha se për vjedhjen në Unazën e Madhe po paguan nga 120 euro çdo familje në të gjithë Shqipërinë. "Unë protestoj jo vetëm për ju, por më duket se 40 milionë është një shifer marramendëse, kur kam qenë në një emision televiziv, një njeje në Liverpool që ishte shumë më e komplikuar se kjo kush-tonte 3 milionë sterlina, ku shkoi 37 milionët e tjera! Qeveritarët vjedhin në një mënyrë të tmerrshme, jo vetëm vjedhin popullin, çdo familje paguan 120 euro për të. Këtu kemi të bëjmë me një grabitje ndaj popullit, si mund t'i heqësh çatinë e shtëpisë një fëmije? Këtë nuk e ka bërë as Enver Hoxha dhe as italianët apo Sali Berisha", u shpreh Baçe.



## Kandidimi në Tiranë? Manjani: Dëshirë, por jo propozim zyrtar

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, reagoi dje pasi emri i tij u lakua nga kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, si kandidat i mundshëm i opozitës për Bashkinë e Tiranës, në zgjedhjet e ardhshme lokale. Brenda janarit do të kemi emra. Kemi diskutuar Dash Shehin, Ylli Manjanin e shumë e shumë të tjerë", shprehej kryemadhi në një intervistë televizive dy ditë më parë. Këtë të mërkurë, ish-ministri i Drejtësisë u shpreh: "Nuk kam marrë asnjëherë asnjë propozim zyrtar nga asnjë forum i asnjërës parti për të qenë kandidat. Unë vetë nuk e kam menduar për asnjë çast këtë gjë. Në kuptimin që nuk më ka interesuar ndonjëherë kjo gjë. Ka pasur njerëz dashamirës të mi, politikanë, gazetarë dhe të tjerë që e kanë shprehur këtë gjë si dëshirë e tyre. Në këtë grup bën pjesë edhe kryetarja e LSI, zonja Monika Kryemadhi. E përsëris, ka qenë një dëshirë e tyre dhe jo një propozim zyrtar e aq më pak pranim nga ana ime. Kjo është e vërteta", shkruan Manjani në "Facebook".

ni të gjithë Unazën e Re. Artan Lame vetëm në muajin shtator ka bërë 10 legalizime të paligjshme, kush duhet futur në burg, ne apo Artan Lame"? Po dje protestuan edhe banorët e Shkozës dhe ata të Bregut të Lumit në mbrojtje të pronave të tyre. Ashtu si dhe banorët e Un-

azës, edhe ata të Bregut të Lumit e Unazës së Madhe kërkojnë kompensim për pronën e tyre, të cilën qeveria kërkon t'ua shembë në emër të projektit për zgjerimin e rrugës. Në mbështetje të kësaj proteste ishte edhe deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku.



**AKUZA**

"Edi Rama ka kohë që ka shkelur vijën e kuqe. Asnjë zhvillim nuk do të sjellë ky projekt korruptiv. Admirim për kurajën e banorëve. Sot jemi në një betejë kundër vjedhjes ku janë ngritur edhe studentët. Kjo është një revoltë qytetare që po vlon në çdo cep të qytetit dhe në qytetet e tjera", - tha Basha.

**"Të rinjtë janë më të goditurit"****Saliianji: Rama po majmet, ndërsa Shqipëria po vlon**

Deputeti i PD-së, Ervin Saliianji përkrah protestën e të rinjve, të cilët sipas tij janë shtresa më e goditur nga qeveria. Saliianji thekson se Rilindja po promovon më të paafët, ndërkohë që të rinjtë ekselentojnë po largohen masivisht nga Shqipëria. "Shqipëria vlon, Ramës kush i ka mbetur? Sot u ngritën studentët, pjesa më vitale por më e goditura nga qeveria. Të rinjtë janë më të papunët, më të pashpresë, më të varfër, pa mundësi, pa rregulla gare, pa hapësira për tu përfshirë në institucione dhe në administratë. Më të paafët promovohen nga Rilindja, ekselentojnë goditën dhe largohen masivisht në eksod. Kriminelët komandojnë studentët e shkëlqyer, dallkaukët udhëheqin arsimin, të marrët bëjnë para ndërsa studentet, nxënësit dhe prindërit e tyre paguajnë me gjak qindarkat e fundit që këto para të shkojnë tenderë për bandat, apo para për të blerë zgjedhjet. Njësoj si studentet janë në protestë qytetarë që po iu shkatërrohet banesa dhe jeta, protestojnë minatorët që u gënjyen për pensionin, protestojnë mjekët dhe infermierët që po largohen çdo ditë, protestojnë mësuesit që nuk kanë asnjë rritje rroge në 6 vite Rilindje, protestojnë bizneset e vogla që mbyllen mijëra në vit, protestojnë agjencitë turistike, pacientët lëngojnë përditë pa ilaçe ndërkohë që miliona eurot e ilaceve të tyre i marrin oligarkët, vuajnë personat me aftësi ndryshe që përveç diskriminimit vuajnë dhe mungesën e trajtimit financiar të nevojshëm, proteston elita intelektuale, bërtasin gazetarët që kërcënohen me burg dhe gjoba! Rama po majmet, Shqipëria po vlon!", - shkruan deputeti i PD.

Kreu i PD-së, akuza Ramës: Tërhiq, revolta qytetare po vlon kudo në kryeqytet

**'Unaza', Basha thirrje protestuesve: Mos u dorëzoni, beteja do fitohet**

*"Rezistoni, të marrim fatet në duart tona"*

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha u kërkoi dje nga afër banorëve të zonës së Astirit që mos të dorëzohen në betejën me qeverinë për të mbrojtur banesat e tyre pasi sipas tij ata do të jenë të fituar. Basha dhe deputetë të opozitës iu bashkuan sërish dje protestës së banorëve të Astirit, të cilët bllokuan rrugën tek Unaza e për të 32 ditë më radhë. I frymëzuar nga rezistenca e banorëve kundër prishjes së banesave, por edhe protesta e studentëve kundër rritjes së tarifave dhe pagesës për lëndët e mbartura, Basha pati një mesazh: Të gjithë bashkë kundër të keqes. "Revolta qytetare po vlon kudo në kryeqytet", deklaroi z.Basha. Kreu i opozitës nuk dha një përgjigje direkte nëse do të vihet në krye të një proteste mbarëkombëtare, por tha se opozita do të jetë në krah dhe në ballë të çdo proteste të qytetare. "Unë jam në krah të çdo proteste dhe si opozitë jemi me çdo qytetar që proteston. Unë kam një mesazh që të qëndrojmë së bashku të gjithë, që të marrim fatet në duart tona", - deklaroi z.Basha. Ai akuzoi se Edi Rama ka shkelur prej kohësh vijën e kuqe dhe u kërkoi qytetarëve të mos dorëzohen, pasi sipas tij beteja do fitohet. "Edi Rama ka kohë që ka shkelur vijën e kuqe. Asnjë zhvillim nuk do të sjellë ky projekt korruptiv. Admirim për kurajën e banorëve. Sot jemi në një betejë kundër vjedhjes ku janë ngritur edhe studentët. Kjo është një revoltë qytetare që po vlon në çdo cep të qytetit dhe në qytetet e tjera. Unë kam një mesazh. Duke vazhduar kështu beteja do fitohet. Mos u dorëzoni se të gjithë së bashku jemi më të fortë dhe do triumfojmë kundër vjedhjes tek Unaza, vjedhjes në universitet dhe duke rikthyer fatin tuaj. Jam i frymëzuar nga qëndresa juaj", - tha Basha. Ai përgëzoi banorët e Unazës së Madhe për qëndresën përgjatë 32 ditëve në protestë. "Është projekti i vetëm që Edi Rama ka për ju. Falënderime nga zemra banorëve të Unazës që kanë treguar se si mund të arrihet zbatim i kësaj keqe kur



Kreu i opozitës Lulzim Basha dje me banorët e zonës së "Astirit"

**MESAZHI**

I frymëzuar nga rezistenca e banorëve kundër prishjes së banesave, por edhe protesta e studentëve kundër rritjes së tarifave dhe pagesës për lëndët e mbartura, kreu i PD-së pati dje një mesazh: "Të gjithë bashkë kundër të keqes. Revolta qytetare po vlon kudo në kryeqytet", - tha z.Basha.

**"Veliaj", Gjoshë: Më shumë fasadë, Kryemadhi u nxor nga konteksti**

Komentet e Monika Kryemadhit për Erion Veliaj, ish-ministria e Integritetit, Klajda Gjoshë i cilëson si të shkëputura nga konteksti. Por Gjoshë ka një mendim të qartë dhe të prerë për Veliajn. Për ish-ministren e Integritetit në mandatin e parë të Erion Veliajt ka mbizotëruar fasada dhe propaganda duke lënë në harresë problemet e vërteta të qytetit. Ajo thotë se fitorja përballë Veliajt është plotësisht e mundur. Shqetësimi kryesor për Klajda Gjoshën është situata aktuale në vend. Ajo shprehet se nuk është asnjë moment në bojkot të plotë dhe mund të marrë pjesë në parlament kur ta shikojë të arsyeshme. Nëse djegia e mandateve

**SITUATA**

Shqetësimi kryesor për Klajda Gjoshën është situata aktuale në vend. Ajo shprehet se nuk është asnjë moment në bojkot të plotë dhe mund të marrë pjesë në parlament kur ta shikojë të arsyeshme.

nuk e shqetëson, ajo shprehet se është e shqetësuar për reformën zgjedhore dhe çështjen e votës. Sipas saj prioriteti i reformës zgjedhore duhet të jetë parandalimi i blerjes së votës, problem që sipas Gjoshës përcakton dhe

votën e LSI. Deputetja e LSI deklaroi se përgjegjësia më e madhe për çështjen e blerjes së votës bie mbi mazhorancën për shkak se ajo duhet të garantojë një sistem të drejtë pasi ka mekanizmat për të blerë vota.

je i bashkuar. Jam i frymëzuar nga qëndresa juaj dhe do vazhdojmë ta mbështesim. Unë jam dhe do jem në krah të çdo proteste. Thirrja që kam sot për qytetarët shqiptarë, për halexhinjtë të cilëve iu është futur në xhep Edi Rama përmes grabitjes, qëndroni bashkë. Bashkohuni, ngrihuni. Luftoni për të ardhmen e fëmijëve tuaj. Duke qëndruar bashkë do fitojmë. Kjo është vjedhja më e madhe e

parave të shqiptarëve dhe vjedhja më e madhe e shënuar ndonjëherë në botë. Ne e kemi denoncuar këtë vjedhje, sot është e faktuar, mediat vazhdojnë të nxjerrin detaje tronditëse të kësaj vjedhjeje. Vjedhje është kjo që bëhet këtu, vjedhje ajo që po bëhet me studentët, vjedhje ajo që po bëhet me Teatrin Kombëtar. T'i zbrapsim nën shembullin e kësaj qëndrese. Kërkojini prokurorës pse nuk e hap

hetimin", theksoi kreu i opozitës. Ai akuzoi përpjekjet e kryeministrit Rama për të përçarë protestuesit. Për këtë Basha iu drejtua gazetarëve: "Bëni detyrën tuaj, mos prisni t'i bëjë të gjitha opozita. E shihni çfarë bën pala tjetër, i përcan, i shan. Po të mos ishim bashkë me këto familje, gjëra më të zezë do kishin ndodhur. Protesta është më e madhe se dje. Pushteti do bëjë gjithçka për t'i ndaluar".

## KRIMI NË POLITIKË

### OPINIONI

Pastrimi i politikës nga krimi, komisioni publikoi opinionin për nismën e PD

# Vetingu, "Venecia": Qëllimi i mirë, por mekanizmi i gabuar

"Amendamentet nuk vijnë në kushtet e një vakumi ligjor"

Komisioni i Venecias e konsideron të drejtë qëllimin e nismës së opozitës për të bërë vetingun në politikë për shkak të situatës aktuale në Shqipëri, por nuk mbështet mekanizmin ligjor që ajo ka zgjedhur për ta arritur këtë gjë. Komisioni ka publikuar dje opinionin paraprak të ekspertëve të tij, që pak ditë më parë vizituan edhe Tiranën, ku ndërsa bënë një panoramë të situatës në Shqipëri, kanë përcaktuar edhe 10 konkluzione në lidhje me nismën ligjore të opozitës. Në këtë draft-opinion ekspertët vlerësojnë se propozimi për verifikimin e politikanëve dhe lidhjeve të tyre me krimin nuk ka qartësi ligjore dhe nuk ofron siguri juridike për vetingun e politikanëve, ndaj si rrugë që mund të sjellë arritjen e këtij qëllimi, ata sugjerojnë dialogun politik mes palëve për të gjetur një zgjidhje të pranueshme.

#### SITUATA

Në draft-opinionin e vet, Komisioni i Venecias bën një analizë të situatës dhe aktualitetit në të cilin vjen kjo nismë ligjore nga ana e opozitës. Në këtë aspekt, ekspertët bëjnë të ditur se, "nga takimet (shkëmbimet e mendimeve) e ndryshme që patën gjatë vizitës në Shqipëri, duket qartë se ekziston vërtet një problem i kontakteve të papërshtatshme midis politikanëve dhe elementeve kriminale". Sipas tyre, rezultoni se: "Çështja e kontakteve të ngushta të anëtarëve të parlamentit, këshillit bashkiak ose zyrtarëve qeveritarë me krimin e organizuar janë një problem në Shqipëri". Për këtë, ata u referohen pikërisht rezultateve të para të procesit të vetingut në drejtësi, ku shumë prej gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë dalë me probleme të integritetit të figurës së tyre dhe lidhje të dyshuara me krimin. "Siç tregojnë edhe rezultatet e para të procedurës së vetingut të gjyqësorit, ndërldhja e institucioneve shtetërore dhe krimi i organizuar duket të jetë shumë i lartë. Kjo pengon besimin në institucionet e shtetit dhe delegjtimin funksionimin e tyre. Nëse krimi i organizuar është duke qeverisur institucionet shtetërore, ose të paktën ka një ndikim në punën e tyre, parimet e shtetit ligjor nuk mund të zbatohen në praktikë. Në një shtet të qeverisur ose të ndikuar nga krimi i organizuar, parimet e dinjitetit, barazisë apo ligjshmërisë janë lënë mënjanë", thuhet në vlerësimet që ekspertët bëjnë situatës në Shqipëri.



Ekspertët e Komisionit të Venecias

#### LIDHJET ME KRIMIN

"Siç tregojnë edhe rezultatet e para të procedurës së vetingut të gjyqësorit, ndërldhja e institucioneve shtetërore dhe krimi i organizuar duket të jetë shumë i lartë. Kjo pengon besimin në institucionet e shtetit dhe delegjtimin funksionimin e tyre".



Komisioni i Venecias

## Vasili: "Venecia" konfirmon shqetësimet e opozitës për krimin në politikë

Opozita e ka konsideruar pozitiv opinionin paraprak të Komisionit të Venecias, lidhur me projektligjin e PD-së për vetingun. Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, ka vlerësuar pikërisht konstatimet që bëjnë ekspertët e komisionit sa i përket gjendjes së kriminalitetit dhe lidhjes së tij me politikën. "Komisioni i Venecias konfirmon qartë e zëza mbi të bardhë që krimi ka pushtuar shtetin dhe ka bërë që qytetarët të humbasin besimin tek institucionet dhe nevoja për veting të politikës është



plotësisht legjitime", shkroi Petrit Vasili në një koment të tij në rrjetet sociale, fill pas publikimit të draft-opinionit. Për këtë, ai i referohet pikërisht pjesës së këtij opinion, ku flitet për kontaktet

e politikës me përfaqësuesit e kriminit. "Megjithatë, për të mos u lënë shkas përthyesve bajatë të qeverisë nga shqipja në shqip, që të shtrembërojnë të vërtetat, po ju sjell ç'thonë ekspertët e 'Venecias' në ligjëratë të drejtë: 'Nga takimet (shkëmbimet e mendimeve) e ndryshme që patën raportuesit gjatë vizitës në Shqipëri, duket qartë se ekziston vërtet një problem i kontakteve të papërshtatshme midis politikanëve dhe elementeve kriminale", shkroi Vasili duke cituar një pjesë të këtij dokumenti.

#### PËRFUNDIMET

Ndërsa merr në analizë të gjitha propozimet që përmban projektligji i opozitës, Komisioni i Venecias del në fund me një sërë konkluzionesh, ku që në krye të tyre theksojnë: "Pa vënë në dyshim qëllimin legjitim për të pas-truar klasën politike shqiptare - dhe duke qenë mendojehapur ndaj nevojave për të

mjete të tjera legjislative, komisioni vëren se amendamentet e propozuara nuk vijnë në kushtet e një vakumi ligjor". Nga ana tjetër, ekspertët e Venecias nënvizojnë se në kushtet e ekzistencës së ligjit të dekrimalizimit, nuk shikojnë vlerën e shtuar për të pasur ndërhyrje të tjera kushtetuese për të bërë kontrollin e figurës së

politikës. "Duke pasur parasysh nenet ekzistuese të Kushtetutës së Shqipërisë dhe implementimet ligjore përkatëse (në veçanti Ligjin e Dekriminalizimit), ashtu si edhe mekanizmat e tjerë demokratike, vlera e shtuar ligjore e propozimeve kushtetuese mund të vendoset në pikëpyetje", thuhet në këtë dokument paraprak. Gjithashtu, ekspertët e komisionit nënvizojnë se, "projektligji nuk arrin të ofrojë udhëzime të përshtatshme dhe masat mbrojtëse të nevojshme, madje edhe në nivelin kushtetues, për një shkallë të tillë të madhe, komplekse dhe të ndjeshme, me implikime të rënda për të drejtat e atyre që i nënshtrohen".

#### PËRFUNDIMET E DRAFT-OPINIONIT

1. Pavarësisht qëllimit të ligjshëm për shkak të situatës aktuale në Shqipëri - atë të largimit të shkelësve dhe ndikimit të tyre në qeverisjen e nivelit të lartë të jetës politike - drafti i propozuar kushtetues për kontrollin e integritetit të politikanëve nuk arrin të ofrojë udhëzime të përshtatshme dhe masat mbrojtëse të nevojshme, madje edhe në nivelin kushtetues, për një shkallë të tillë të madhe, komplekse dhe të ndjeshme, me implikime të rënda për të drejtat e atyre që i nënshtrohen. Sa i përket konceptimit të tij aktual, vetingu i propozuar nuk ka qartësi ligjore dhe siguri juridike, si për sa i përket qëllimit të tij, arsyt për moszgjidhje dhe humbjen e mandatit dhe mekanizmin e zbatimit të tij. Në shumë aspekte, ai gjithashtu ngre çështje të proporcionalitetit.
2. Projektligji nuk arrin të përcaktojë elemente të caktuara kryesore, veçanërisht (i) se çfarë nënkuptohet pasja e kontaktit me persona të caktuar; (ii) çfarë nënkuptohet me përfshirje në krimin e organizuar dhe (iii) çfarë nënkuptohet me përfshirje në rrethin e subjekteve që kanë kontakte me personat.
3. Është e pagatë se cilat dispozita duhet të udhëheqin procedurën e verifikimit. Mungesa e deklaratave (përveç kërkesës për një shumicë prej 3/5) në një propozim që gjithsesi në disa vende janë mjaft të detajuara, së bashku me futjen e propozuar të dy dispozitave kryesore në Kushtetutë si "masë e jashtëzakonshme" krijojnë mundësinë e moszbatimit të procesit të rregullt, të duhur ligjor, pra që procedurat të mos zbatohen.
4. Nuk është e qartë se kush do të kryejë verifikimin e zyrtarëve publikë dhe kandidatëve zgjedhorë dhe nëse kjo do të bëhet nga një organ gjyqësor ose një organ tjetër i pavarur. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse çdo skualifikim duhet të jetë i përhershëm ose i kufizuar në kohë. Në këto aspekte, siguria ligjore mungon. Përveç kësaj, nuk janë propozuar masa mbrojtëse për të shmangur rrezikun që do të përdoret në një politikisht i njëanshëm ose arbitrar.
5. Në kërkesën e tij për zyrat e zgjedhur, projektligji nuk është në përputhje me Nenin 3 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së dhe Kodi i Praktikës së mirë në çështjet zgjedhore. Përkufizimi "Duke pasur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar" ofron një mundësi shumë të gjerë për të kufizuar të drejtën për t'u zgjedhur, pavarësisht nga natyra e "kontakteve". Nuk parashikon një vendim gjyqësor ose një vendim nga një tjetër organi i pavarur për heqjen e lirisë dhe kufizimit dhe nuk ka një natyrë të përkohshme. Siç duket, propozimi në të vërtetë mund të çojë lehtësisht në shumë raste të abuzimit me pushtetin.
6. Për sa kohë që verifikimi ka për qëllim të zbatohet ndaj zyrtarëve të pazgjedhur, pasiguria rreth qëllimit të tij dhe skema e zbatimit e bëjnë të vështirë të shihet si të zbatueshme Neni 6 KEDNJ të drejtat do të garantohen nga projekt-amendamentet kushtetuese nëse miratohen në këtë formë.
7. Këto paqartësi gjithashtu e bëjnë të pamundur që Komisioni i Venecias të gjykojë nëse propozimi mund të konsiderohet një përgjigje proporcionale ndaj asaj, që padyshim është vërtet problem në Shqipëri.
8. Për më tepër, merren parasysh dispozitat ekzistuese të neneve 6/1, 45 (3) dhe 179/ a të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të legjislatcionit përkatës zbatues (në veçanti Ligji për Dekriminalizimin), si dhe mekanizmat e tjerë demokratikë në dispozicion, ligjet e shtuara vlera e amendamenteve të propozuara kushtetuese mund të vihet në pikëpyetje.
9. I përket Parlamentit shqiptar të vendosë për hapet e ardhshme në lidhje me propozimin ndryshimet kushtetuese, përmes dialogut konstruktiv midis të gjitha forcave politike dhe të shoqërisë në përgjithësi, në interes të demokracisë shqiptare.
10. Komisioni i Venecias mbetet në dispozicion të autoriteteve shqiptare për ndihmë në mëtejshme në këtë çështje.

#### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILJA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69-2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.445.148, 8 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.12.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .





#### VENDIMI PËR VETINGUN NË MES TË DHJETORIT

Komisioni i Venecias do të marrë vendimin përfundimtar në 14-15 dhjetor për opinionin rreth nismës së opozitës për vetingun në politikë. Ndërkohë që ka dalë draft-opinionin rreth kësaj i përgatitur nga ekspertët, Komisioni i Venecias do të marrë vendimin përfundimtar pikërisht gjatë mbledhjes në sesionin që mbahet pikërisht në mes të dhjetorit. Gjithsesi, takimi i 14 dhe 15 dhjetorit në rast të tilla është formal, pasi komisioni në përgjithësi miraton propozimet dhe gjetjet e ekspertëve që kanë shqyrtuar çështjen në fjalë.

#### Vetingu, opozita thyen bojkotin

Opozita ka thyer dje bojkotin dështimor dhe është kthyer në Kuvend. Bëhet fjalë për rikthimin e saj në Këshillin e Legjislacionit, ku dje u diskutua nisja e saj për vetingun në politikë. Pavarësisht bojkotit që i ka bërë këtij institucioni që nga vera e shkurtit, PD dhe LSI kanë çuar dje përfaqësuesit e tyre në Këshillin e Legjislacionit, ku ekspertët të së drejtës kanë dhënë opinionet e tyre rreth nismës së opozitës për të bërë vetingun edhe në politikë. Avokati i Shtetit, Artur Metani, gjatë fjalës së tij para të pranishmëve u shpreh se ka paqartësi se cila do jetë struktura që do bëjë procesin e vetingut dhe se projektligji nuk është në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Ndërkohë që ekspertët i PD-së, Gazmend Bardhi, tha se kufizimi me ligj i të drejtave të caktuara politike është i pranueshëm nëse kufizon influencën kriminale.

Ambasadori i BE-së përshëndeti vendimin për t'i dhënë vendit tonë kryesimin e OSBE-së

# Shqipëria bëhet pjesë e trojkës së OSBE-së, në 2020 merr drejtimin

Ministria ka shtuar fondet financiare për këtë angazhim

Është miratuar kandidatura e Shqipërisë për kryesinë e Presidencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nga viti 2020. Ndërkohë që nga 1 janari 2019, Shqipëria do të jetë pjesë e trojkës drejtuese të kësaj organizate, ndërsa nga viti 2020 do marrë kryesimin e rrethës së saj. Lajmin e ka bërë të ditur kryesuesja aktuale e OSBE-së, Italia, përmes një postimit në "Twitter". Shqipëria ishte kandidatura me potencialet më të madhe për të marrë kryesimin e OSBE-së në 2020. Vendimi do të konfirmohet sot në Ministerialin e Milanos dhe kjo është hera e parë që Shqipëria do të marrë kryesinë e kësaj organizate të rëndësishme. Ndërsa deri tani përgjithësisht vendi ynë genë kryesisht konsumator i pranisë së OSBE, tashmë ai kthehet në një kontributor kryesor në drejtimin e kësaj organizate të rëndësishme ndërkombëtare. Në fakt, marrja e kryesimit të OSBE-së ishte bërë një qëllim për Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme, e cila në funksion të këtij qëllimi ka parashikuar edhe një fond të shtuar financiar për vitin e ardhshëm, pikërisht për të përballuar detyrimet që lindin nga kjo përgjegjësi e re. Afro dy javë më parë, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, tekta prezantonte projektbugetin e dikasterit që ai drejton



në Komisionin parlamentar të Punëve të Jashtme, tha se me bërjen pjesë e trojkës së OSBE-së, tashmë për Shqipërinë do të lindin disa detyrime. "Në rast se një gjë e tillë do të rezultojë e suksesshme që në vitin 2019, për Shqipërinë do të lindin disa detyrime për shkak të hyrjes së vendit tonë në trojkën e OSBE-së dhe kjo është arsyeja që pse në 2019-ën, në buxhetin e shtetit është parashikuar një fond specifik për aktivitetet që do të ndërmerren Shqipëria gjatë vitit 2019", u shpreh Bushati gjatë asaj mbledhjeje. Ndërkohë që me në vitin 2020, me marrjen e presidencës së OSBE-së, do të duhet që ky fond të jetë akoma më i madh, për të realizuar të gjitha detyrimet që ka një vend që mban drejtimin e OSBE-së.

#### SORECA

Zgjedhjen e Shqipërisë si pjesë e trojkës dhe me të drejtën për të marrë drejtimin e OSBE-së në 2020-ën e ka përshëndetur edhe ambasadori i BE-së në vendin tonë, Luigi Soreca. Në një postim në "Twitter", Soreca shpreh mbështetje për këtë rol të rëndësishëm që do të marrë Shqipëria. "Ambasada e BE në Shqipëri mirëpret vendimin për miratimin e kandidaturës së Shqipërisë për kryesimin e OSBE-së. Presim me padurim t'i japim mbështetjen tonë Shqipërisë edhe për këtë rol të rëndësishëm", shkruan ambasadori i BE. Shqipëria ishte kandidatura më e fortë për të marrë kryesimin e OSBE në 2020 dhe lajmi u bë i ditur sot nga Italia, e cila aktualisht kryeson Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. OSBE u krijua gjatë Luftës së Ftohtë, si një forum për dialog mes Lindjes dhe Perëndimit. Ajo sot vepron në tri

#### MESAZHI

"Ambasada e BE në Shqipëri mirëpret vendimin për miratimin e kandidaturës së Shqipërisë për kryesimin e OSBE-së. Presim me padurim t'i japim mbështetjen tonë Shqipërisë edhe për këtë rol të rëndësishëm", shkruan ambasadori i BE.

fusha: ushtarako-politike, ekonomike-ekologjike dhe njerëzore. Ajo ka selinë në Vjenë dhe mbledh 57 shtete anëtare nga Evropa, Azia Qendrore dhe Amerika e Veriut, të cilat së bashku përbëjnë pjesën më të madhe të hemisferës veriore.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë është forum dialogu politik për një gamë të gjerë çështjesh të sigurisë si dhe platformë për veprim të përbashkët, me qëllim përmirësimit e jetës së individëve dhe komuniteteve.

#### Presidenti vlerëson Thaçin me "Nënë Tereza"

### Meta promovon librin mbi humanisten austriake, Graf

Në ambientet e Presidencës u promovua dje libri i Lindita Sinës, kushtuar veprimtarës humaniste dhe bamirëse austriake, Marianne Graf, me titullin: "Marjana - Historia shqiptare e një austriakeje". Presidenti Meta theksoi se znj. Graf me veprimtarinë e saj humanitare në Shqipëri dhe jo vetëm ka lënë gjurmë të mëdha. Ai tha se historikisht, Austria dhe austriakët e kanë treguar me vepra miqësinë për popullin tonë dhe për këtë u jemi shumë falënderues. "Për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve Marianne së bashku me bashkëshortin e saj, z. Willi Graf, themeluan shoqatën, 'Partneriteti Shqipëri-Austri' ('Albanien-Austria- Partnerschaft'). Përmes kësaj shoqate u afruan edhe më shumë dy kombet dhe vendet tona, u ndje edhe më fort miqësia e singërtë e austriakëve ndaj shqiptarëve. Për shumë austriakë, emri i Shqipërisë lidhet me emrin, Marianne Graf. Ashtu sikurse për shumë shqiptarë, të cilët e kanë ndërjerë dorën e ngrohtë të ndihmës së saj. Emri i Austrisë lidhet pagjydhshëm me emrin e saj. Për shqiptarët, Marianne është shqiptarja austriake. Për austriakët, Marianne është austriakja shqiptare", tha Meta. Po dje, Presidenti vlerësoi z. Skënder Thaçi me dekoratën e lartë "Nënë Tereza", me motivacionin: "Për kontributin e dhënë për realizimin e një numri të konsiderueshëm projektesh për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore, si dhe ndihmesën ndaj shtresave në nevojë, në zona të ndryshme të Shqipërisë".



#### SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmirësimi "E.G. Bailiff Service" me përfaqësues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rrnuva, Pallat 64, Hyjta 8, Ap. 1, Tirane, njofton se më datë 14.12.2018 ora 8:00 - 16:00 në ambientin e saj, do të zhvillohet Ankandi i rrethit për shitjen e pasurive të paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 112 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr. pasurie 16/136, Vol.6, Fq.122, ZK.8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIK BETHON" Sh.P.K. me vlerë fillestare në ankand 11.646 (Njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) EURO dhe Pasuri e paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 1260 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr. pasurie 16/235, Vol.7, Fq.236, ZK.8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIK BETHON" Sh.P.K. me vlerë fillestare në ankand 131.040 (Njëqind e tridhjetë e një mijë e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 21 888, email enuar.merko@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

#### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje dhe aksesore të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,718,400 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqjen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje dhe aksesore të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferata duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 10 Janar 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## PERSONAT E ZHDUKUR HETIMET

Policia: 15 prej të zhdururve dyshohet se mund të jenë vrarë, 2 janë rikthyer në banesa

# Zbulohet lista, ja kush janë 22 personat e zhdurkur në Vlorë gjatë 3 viteve të fundit

*Prokuroria e Krimeve të Rënda, hetime për Albano Xhaferrin, Elvis Troqen e Leonard Mehmetin*

TIRANË

Pak ditë pas deklarimit të Policisë së Vlorës se përgjatë 3 viteve të fundit janë zhdurkur 23 persona në qytetin bregdetar, dosjet për të paktën tre prej tyre kanë kaluar te Krimet e Rënda. Dy nga të zhdurkurit e fundit në Vlorë që dyshohet se janë ekzekutuar nga grupet kriminale, janë Albano Xhaferrin dhe Elvis Troqen, të cilët kanë humbur gjurmët përkatësisht në qershor dhe korrik të këtij viti. Ndërkaq, Krimet e Rënda po hetojnë gjithashtu edhe për Leonard Mehmetin, i njohur si Nani, sipërmarrës në Vlorë, i cili është zhdurkur më 22 nëntor të vitit 2016. Nga deklarimet e familjareve, mendohet se Mehmeti kishte miqësi me ish-efektivin e policisë, Ervin Dalipajn dhe Xhino Dautajn, të dy të ekzekutuar në 2017-ën në autostradën Tiranë-Durrës. Ervin Dalipaj ishte në kërkim si i dyshuar për rrëmbimin dhe ekzekutimin e Gazmend Çollakut. Ndërkohë, Prokuroria e Vlorës ka publikuar listën me emrat e personave të denoncuar të zhdurkur, por vetëm për katër çështje ka procedim penal, pasi janë gjetur elemente të veprës penale. Grupi hetimor ka dyshime se zhdurkja e disa prej tyre ka ardhur për larje hesapësh apo hakmarrje për çështje që kanë të bëjnë me veprimtari të paligjshme, kryesisht drogën. Burime nga policia bëjnë të ditur se nuk përjashtohet mundësia që ata të jenë vrarë, por për sa kohë nuk ka trupa të zbuluar, këta persona konsiderohen të zhdurkur.

### EMRAT E DENONCUAR TË ZHDUKUR

Albano Haskaj, i larguar me 07.09.2016/ Aldo Likaj, i larguar me 04.10.2016/ Leonard Mehmeti (Nani) larguar me 21.11.2016/ Elidon Ferrataj, larguar me 29.11.2016/ Adrian Jaho, larguar me 03.07.2017/ Ariseldo Maze, larguar 03.07.2017/ Besho Mahmutaj, denoncuar më 2017/ Gjergji Kokoshari, larguar me



Albano Xhaferrin



Elvis Troqen

20.03.2017/ Lavdos Sinanaj, denoncuar në 2017/ Marjo Metushi, larguar me 16.06.2017/ Majlinda Koçi, larguar me 05.03.2018/ Shpresa Boka, larguar me 2018/ Shpëtim Pasha, larguar në 2015/ Teuta Pasha, larguar në 2015/ Saimir Pashaj larguar me 02.11.2018/ Albano Xhaferrin, larguar me 18.06.2018/ Ervis Troqen, larguar me 17.07.2018/ Fatos Sulaj, larguar me 01.06.2018/ Gentian Çollaku, denoncuar në 2018/ Ksandro Imeraj larguar 02.02.2018/ Edmond Durrmishi, i larguar nga spitali psikiatrik, i rikthyer/ Eduard Habibi, larguar me 19.05.2018, i rikthyer. Disa prej ngjarjeve të bëra publike nga

të afërmit e tyre janë: zhdurkja e biznesmenit Adriano Jaho, 52 vjeç dhe ndihmësit të tij, Ariseld Maze 28 vjeç. Ata dolën në det më 3 korrik të 2017-ës nga porti i Vlorës, por nuk u kthyen më. Ksandro Imeraj, 32 vjeç është një tjetër i ri, zhdurkja e të cilit u denoncua nga të afërmit nëpërmjet medias. Ai u largua në mars të këtij viti dhe dyshohet se është mbytur në rrethana të paqarta në det, teksa ishte nisur drejt Italisë me një mjet lundrues. Ndërkohë që ende e mistershme mbetet vetëvrasja e vëlait të tij dy muaj më pas. 26-vjeçari Albano Imeraj u gjet pa jetë pranë monumentit të

### HETIMET

Prokuroria e Krimeve të Rënda po heton dosjet e tre të zhdurkurve në Vlorë. Njëra prej tyre është dosja e Leonard Mehmetit, i njohur ndryshe si "Nani", i cili rezultoi i zhdurkur në vitin 2016. Hetimi për këtë rast u nis nga Prokuroria e Vlorës, por i kaloi Krimeve të Rënda, pasi ka dyshime se pas zhdurkjes së tij qëndron një grup i strukturuar kriminal dhe motiv dyshohet të jetë konflikti për drogën. Nga deklarimet e familjareve, mendohet se Mehmeti kishte miqësi me ish-efektivin e policisë, Ervin Dalipajn dhe Xhino Dautajn, të dy të ekzekutuar në 2017-ën në autostradën Tiranë-Durrës.

pavarësisht në Vlorë. Mes të shpallurve të larguar nga banesa është edhe Gentian Çollaku, i shpallur në kërkim për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, ngjarje e ndodhur në Orikum, ku i riu ka grabitur me armë një karburant. Policia e ka referuar rastin në prokurori, por dyshohet se humbja e kontakteve të tij me familjarët është për shkak të tentativës për t'u shmangur dënimit. Sipas të dhënave nga policia, katër prej të zhdurkurve kanë humbur në det, në tentativë për të transportuar lëndë narkotike në Itali. 15 të tjerë rezultojnë të zhdurkur në mënyrë misterioze, por disa prej të cilëve dyshohet se mund të jenë vrarë. Vetëm gjatë këtij viti janë 13 denoncime për të zhdurkur në Vlorë. Ndërkaq, Edmond Durrmishi, Eduard Habibi, emrat e të cilëve rezultojnë në listën e të zhdurkurve të bërë publike nga organet ligjzbatuese, janë kthyer në banesë.



Banesa e familjes Aga

### SHKURTE

#### Abuzimi, prangoset ish-drejtori e Hipotekës dhe 4 punonjës

**KORÇË** - Ish-drejtori i Hipotekës së Korçës si dhe katër punonjës janë arrestuar nga policia, pasi Gjykata e këtij rrethi ka vendosur ndaj tyre masën e sigurisë "Arrest me burg". Në pranga kanë përfunduar ish-kryerregjistruesi, Leftjon Bardho si dhe punonjësit: Ersild Gorari, Arsidea Hysi, Erjon Arif dhe Andrea Zallëmi. Sipas policisë, këta persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë përfutur në mënyrë të paligjshme para, përmes dhënies së dokumenteve fiktive qytetarëve duke u dhënë në këmbim certifikata të rreme pronësie. "Specialistët e Seksionit për Krimin Ekonomik-Financiar, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, bënë ekzekutimin e urdhrat të Prokurorisë, për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për ndalimin e shtetasve: L.B., 33 vjeç, banues në Korçë, (me detyrë ish-Drejtor në ZVRPP-Korçë); E.G., 34 vjeç, banues në fshatin Barç, (ish-punonjës në ZVRPP-Korçë); A.H., 28 vjeç, banues në Korçë, (me detyrë regjistruar në ZVRPP-Korçë); E.A., 36 vjeç, banues në Korçë, (ish-punonjës në ZVRPP-Korçë) si dhe A.Z., 65 vjeç, banues në Korçë. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për veprime të mëtejshme hetimore", thuhet në mes të tjerash në njoftimin e policisë.

#### Operacioni, arrestohet italiani i shumëkërkuar për trafik droge

**DURRËS** - Një operacion ndërkombëtar i Policisë Shqiptare, Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Karabinierisë së Barit është finalizuar me sukses në qytetin bregdetar të Durrësit. Pas një hetimi intensiv disamujor me metoda speciale u zbulua vendbanimi dhe u kap një shtetas i shumëkërkuar në nivel ndërkombëtar duke finalizuar me sukses operacionin e koduar "Il Latitante". Bëhet fjalë për shtetasin italian Giovanni Di Cosimo, 40 vjeç, lindur dhe banues në Bari, Itali. Në ngarkim të tij, Gjykata e Barit ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike", në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Për këtë veprë penale maksimumi i dënimit është 20 vjet burgim.

#### "Babale", lihet në fuqi masa

#### "arrest në burg" për Fredi Alizotin

**TIRANË** - Gjykata e Apelit në Tiranë ka lënë në fuqi masën "arrest me burg" për Fredi Alizotin, i cili dyshohet si personi që imitoi zërin e Agron Xhafajt në dosjen "Babaja". Alizoti akuzohet për "kallëzim të rremë". Ndërkohë, Apeli la në fuqi edhe masën "Detyrim paraqitje" për gazetarin Jetmir Ollashi. Mësohet se Albert Veliu, i njohur ndryshe si "Dëshmitari X" tek dosja "Babaja" nuk e ka ankimuar masën "arrest me burg". Ai aktualisht ndodhet në Kosovë, në statusin e azilkerkuesit.





Enver Doçi

DIBËR

Një 21-vjeçar nga fshati Grezhdan i Dibës është zhdukur që prej një jave, ndërsa nuk ka asnjë informacion për vendndodhjen e tij. Bëhet fjalë për të riun Mateo Aga, nipin e ish-shefit të Komisarariatit të Dibrës, Robert Aga (aktualisht shef i Qarkullimit Rrugor në Qarkun e Kukësit). Kanë qenë familjarët, të cilët të alarmuar kanë bërë denoncim në polici. Ata deklaruan dje për "Gazeta Shqiptare", se dyshojnë që Mateo është rrëmbyer, ndërkohë që kanë treguar lëvizjet e fundit të 21-vjeçarit, përpara se të zhdukej. Prindërit dhe të afërm të të riut pohuan se mbrëmjen e 28 nëntorit Mateo ka qenë në një lokal në pranë rreth rrotullimit në Maqellarë dhe më pas është kthyer në banesë me makinën e një bashkëfshatari. "Mateo nuk kishte telefon me vete kur është larguar nga lokali. Prej më shumë se një muaji ai s'ka folur fare në telefon, pasi nuk ka pasur. Fliste me telefonat e shokëve, pasi të vetin e kishte të thyer. Kemi frikë mos i kanë ngritur shokët kurth", thanë familjarët. Gjithashtu, ata pohuan se e kanë kërkuar kudo 21-vjeçarin, por nuk kanë mundur ta gjejnë. Menjëherë, pas denoncimit për zhdukjen e Mateo Agës, policia dhe prokuroria e Dibrës kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Hetuesit e çështjes kanë nisur marrjen në pyetje të të gjithë personave që e njohin të riun dhe ata që e kanë takuar për herë të fundit. Ndërsa, në pikat kufitare me Maqedoninë është shpërndarë fotoja e tij, por deri tani nuk ka asnjë gjurmë. Ndërkaj, Nexhat Agolli, gjyshi nga nëna i Mateo Agës u shpreh se është i sigurt që nipi është rrëmbyer. Madje, të afërm të të riut të zhdukur dyshojnë se ai mund të jetë vrarë. Nga ana tjetër, ngjarja është e veshur me mister, pasi nuk dihen motivet e rrëmbimit apo të vrasjes së mundshme të 21-vjeçarit.

**NOJARJA**  
Që prej një jave, familja Aga nga fshati Grezhdan është në ankth për fatin e djalit të tyre 21-vjeçar. Mësohet se kjo familje ishte zhvendosur prej disa kohësh në Tiranë, ndërsa kryefamiljari dhe djali i tij, Mateo punon ende në biznesin e tyre të ngritur në Maqellarë. Më 28 nëntor, i riu ka punuar së bashku me të atin në biznesin e tyre dhe në mbrëmje, rreth orës 20:40 ai ka shkuar në një lokal që ndodhet tek rreth rrotullimi i Maqellarës. Pasi ka qëndruar për një orë i ulur vetëm në lokal,

Gjyshi i Mateo Agës, apel policisë: Më gjeni nipin, s'kishte probleme me askënd

## Zhdukët prej një jave nipi 21-vjeçar i ish-shefit të Komisarariatit të Dibrës

*Familjarët: Dyshojmë se djalin e kanë nxjerrë nga banesa dhe e kanë rrëmbyer, shokët mund t'i kenë ngritur kurth*



21-vjeçari i zhdukur, Mateo Aga



Gjyshi i të riut, Nexhat Agolli, duke folur për "GSH"

**"Ishte në lokal. Iku në shtëpi me makinën e bashkëfshatari"**

### Dëshmitari nga Maqellara: Kur e pashë për herë të fundit të riun Mateo Aga

**DURRES-** "Mateo Aga ishte këtu para se të humbte gjurmët. Ai u largua bashkë me një bashkëfshatarin e tij për në fshat". Kështu ka deklaruar banakieri i lokalit në rreth rrotullimit e Maqellarës, Erald Nurcja, i cili ka qenë një nga personat që ka parë për herë të fundit 21-vjeçarin nga fshati Grezhdan, që rezultoi i zhdukur prej 8 ditësh. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", i riu tha se Mateo Aga dukej i shqetësuar.

**A ka qenë qen Mateo Aga në këtë lokal?**

Zotëria ka ardhur këtu më datë 28, rreth orës 20:40. Ai iku bashkë me një bashkëfshatarin e tij rreth orës 21:35, që kishte rrugën me makinë afër shtëpisë. Që aty s'di më.

**Më kë po e pinte kafën?**

Vetëm ka qenë në tavolinë. I ka marrë dikujt



Dëshmitari Erald Nurcja, duke folur për "GSH"

telefonin dhe ka chatuar.  
**Po me bashkëfshatarin e tij si u takuan?**  
Po njiheshin ata.  
**Ishte në lokal dhe ai?**

Po, ishte edhe ai në lokal.  
**Po pse nuk u ulën bashkë?**  
Ishin duke lozur letra.  
**Kush ishte i pari që tha**

**se do largohej?**

Ishte Mateo. Ai tha se do të largohej për në shtëpi. Bashkëfshatari i tha: Po vij dhe unë meqë po ikën.

**Bashkëfshatari kishte makinë? Po Mateo?**

Po, bashkëfshatari i tij kishte, Mateo jo. As telefon nuk kishte.

**Në lokal atë ditë si shfaqej, ishte i mërziut?**

Dicka e tillë. Ishte i vrenjtur.

**Vetëm kafe piu?**

Jo, nuk ka pirë asgjë.

**Sa qëndroi?**

Gati një orë. Po rrinin tek soba, po ngroheshin.

**Të jepte ndonjë shenjë që ishte i mërziut, i stresuar?**

Nuk e di ç'të them. Do ketë pasur ndonjë shqetësim.

en dhe as dyshime se kush mund ta ketë rrëmbyer. Shpresojmë që ai të jetë gjallë, u shpreh i mosuar. Ndërkaj, Agolli pohoi se Mateon do ta ketë thirrur ndonjë shok apo i njohur dhe më pas ai ka dalë nga banesa dhe nuk është kthyer më. Gjyshi i 21-vjeçarit u bën apel organeve të drejtësisë që të gjejnë nipin dhe ta kthejnë në shtëpi.

**Banorët: Mateo, djalë i urtë dhe pa probleme, dëgjua zhurmë pas mesnate**

**DIBËR** - Zhdukja në rrethana misterioze e 21-vjeçarit Mateo Aga ka tronditur banorët e fshatit Grezhdan. Ata dhanë dje detaje të reja në lidhje me lëvizjet e të riut, vendndodhja e të cilit nuk dihet që prej një jave. "Mateo është kthyer në banesën e tij rreth orës 21:35 të datës 28 nëntor. Në atë orë dëgjua një zhurmë makine që ndaloj para banesës së familjes Aga si dhe zhurmën e portës së hekurt", u shpreh një fqinj i familjes në fjalë. Ndërkohë, një tjetër pohoi se ka dëgjuar zhurmë pak pas mesnate. Kohë kjo që dyshohet se 21-vjeçari ka dalë nga banesa e tij. Gjithashtu, banorët e zonës u shprehën se Mateon e njohin për djalë të urtë, punëtor dhe pa probleme. "Është djalë i qetë dhe shikon punën e tij. Nuk dimë të ketë pasur probleme me ndonjë person. Patra tri vitesh i arrestuan babain, Pajtim Agën, pasi u kam me gjysmë kg kokainë. Ai e ka kryer dënimin dhe tani merret me biznesin e familjes së tij", pohuan banorët të fshatit Grezhdan.

ngjyrë ushtarake.

**GJYSHI I TË ZHDUKURIT**

Pas zhdukjes së 21-vjeçarit, ka reaguar gjyshi i tij, Nexhat Agolli. 70-vjeçari tha për "GSH"-në se Mateo është djalë i qetë dhe jo problematik. "Nipi nuk ka pasur probleme me askënd. Jemi shumë të tronditur nga ajo që ka ndodhur: 99 për qind dyshoj se Mateon e kanë rrëmbyer. Nuk e dimë arsye

pi, familjarët thanë se Mateo sapo është kthyer në shtëpi ka ndezur televizorin (të cilin e ka fiksuar para se të flinte) dhe ka pirë duhan. Ai nuk ka fjetur të dhoma e gjumit, por në një nga kolltukët në dhomën e ndenjes. Dyshohet se pak pas mesnate, dikush (shok) e ka thirrur Mateon dhe ai ka ndërruar rrobat që kishte veshur dhe mendohet se ka veshur rroba të tjera dhe një xhup

Nuk jepet identiteti i mikut të viktimës, thuhet se është shqiptar

# Mediat greke: Futbollisti shqiptar u vra nga shoku

*Mjekoligjorët: Marios Isak mori një plumb në gjoks*

Futbollisti shqiptar i Heracles që u vra të martën mbrëma më 4 dhjetor, është qëlluar nga shoku i tij shqiptar, i cili ka pranuar krimin. Mediat greke raportojnë se Marios Isak, 18-vjeçar, lindur dhe banues në Kavalla, Greqi, është vrarë me një plumb në gjoks. Identiteti i autorit nuk bëhet i ditur, por mediat greke thonë se ai ka deklaruar përpara policisë se me Marion kishte qenë në një bar kafe dhe kur po largoheshin janë grindur gjatë rrugës. "Doja vetëm ta trembja jo ta vrisja, por e kam qëlluar gabimisht"- mësohet të ketë thënë shoku i futbollistit shqiptar. Ekspertiza mjeko-ligjore ka saktësuar se viktimë është qëlluar në krahë dhe plumbi i ka prekur mushkërinë, ndry-



Vendi ku ndodhi ngjarja

she nga sa u raportua fillimisht se ishte qëlluar me dy plumba pas shpine. Sipas

mjekëve ligjorë viktimë ka tentuar të largohet me vrap pasi u qëllua, por pas disa

metrash ka rënë në tokë. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e kaluar rreth orës 22:00 teksa i riu i ishte drejtuar banesës së tij në një rrugicë të errët. Ishin banorët e ata të cilët dëgjuan të shtënat e armës dhe njoftuan menjëherë policinë, e cila rrethoi zonën dhe shoqëroi disa persona si të dyshuar për ngjarjen. Mes të cilëve edhe autori shqiptar, i cili ka pranuar autorësinë e krimit. Marios Isak kishte lindur në Greqi në vitin 2000, ndërsa prej disa vitesh jetonte bashkë me prindërit në Kavalla. Ai ishte futbollist dhe aktivizohej me Heracles, ekip i qytetit ku banonte. Për ngjarjen regjistruan edhe drejtuesit e shoqatës së shqiptarëve të



18-vjeçar, Marios Isak

## LAMTUMIRA

Marios Isak do t'i jepet lamtumira e fundit ditën e premte. Ai është shqiptari i katërt që vritet në Greqi gjatë tre javëve të fundit. Pak ditë më parë u vra Altin Mullai nga një shkëmbim me armë zjarri me policinë greke në tentativë për të trafikuar drogë drejt Greqisë. Më pas ishte Petrit Zifile që u ekzekutua në Korfuz nga një anëtar i 'Agimit të Artë' pas një debati me të për minoritarin Konstandin Kaçifas që u vra në Gjirrokastër, ndërsa një 35-vjeçar u gjet i pajetë në burgun e Trikalasë, shkaqet e vdekjes të të cilit ende nuk dihen.

## Keqardhjen e thellë për humbjen e jetës së të riut shqiptar

Ministria e Jashtme: Fushata e urrejtjes, do ndihmojmë familjarët

Vrasja e një tjetër shqiptari në Greqinë fqinje ka sjellë sërish reagimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila me ashpërsi dënon ekstremizmin dhe gjuhën e urrejtjes. MEPJ shpreh keqardhjen e thellë për humbjen e jetës së të riut shqiptar dhe i shpreh ngushëllimet më të ndjera familjes dhe të afërmeve të tij. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë është në kontakt me familjen e të ndjerit për ofrimin e asistencës së nevojshme. MEPJ shpreh nderin për indinjtën e thellë për humbjen e jetëve të bashkëkombësve tanë, ndjenja këto që thellohen nga vonesat në zbardhjen e këtyre ngjarjeve nga autoritetet greke. "MEPJ dënon ashpër sfondin e ekstremizmit dhe gjuhës së urrejtjes që ka shoqëruar këto ngjarje në vendin fqinj dhe i bën thirrje autoriteteve greke për dënimin dhe vënien fre të çfarëdo përpjekjeje të Agimit të Artë apo segmenteve të tjera ekstremiste për të cenuar sigurinë dhe dinjitetin e shqiptarëve që punojnë e kontribuojnë në vendin fqinj. Nuk pra-



Ministria e Jashtme

## SIGURIA

MEPJ dënon ashpër sfondin e ekstremizmit dhe gjuhës së urrejtjes që ka shoqëruar këto ngjarje në vendin fqinj dhe i bën thirrje autoriteteve greke për dënimin dhe vënien fre të çfarëdo përpjekjeje të Agimit të Artë apo segmenteve të tjera ekstremiste për të cenuar sigurinë dhe dinjitetin e shqiptarëve që punojnë e kontribuojnë në vendin fqinj.

nojmë kursesi të mësohemi as me thirrjet e tyre ksenofobe në kanalet e komunikimit dhe as me viktimizimin patetik e nacionalist të ndonjërit syresh që nuk lë rast pa sulmuar Shqipërinë në instancat evropiane"-thuhet në deklaratë. Ministria e Jashtme shprehu angazhimin e

shtetit shqiptar për t'i dhënë viktimave dhe familjeve të tyre mbështetjeje dhe nevojshme ligjore dhe financiare për të mbrojtur të drejtat e tyre themelore, si pjesëtarë të komunitetit më të madh evropian që jeton, studiojnë dhe kontribuon prej dekadash në Greqi.

## Ngjarja



PISTA

Policia greke e Kavalës pritet që të sqarojë ngjarjen dhe rrethanat e plota për vrasjen e 18-vjeçarit. Marios Isak iu gjet në dorë një shumë parash 50 euro, për të cilat mediat greke aluduan se vrasja mund të kishte ndodhur për pazare droge. Por kjo pistë nuk është konfirmuar zyrtarisht nga autoritetet.

Kavallës, të cilët dënuan krimin dhe përcollën fjalët më të mira për të riun sh-

qiptar si njeri i qetë dhe model i integritetit në komunitetin lokal.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje 5 copë makina sortimi për nevojat e degëve të Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqeruar me ftesa direkte kandidateve te hua", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 40,365,000 Lekë ose 323,700 Euro".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje 5 copë makina sortimi për nevojat e degëve të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 08 Janar 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.





Voltiza Duro

Diskutim me analistin shqiptaro-amerikan. Ndërthurje e praktikës me teorinë

# Universiteti "Luarasi", leksion të hapur mbi marrëveshjen për detin

*Alibali: Profesionalizëm dhe cilësi, dy pika të fuqishme*

Në kuadër të kombinimit të teorisë me praktikën, universiteti "Luarasi" vijon traditën e leksioneve të hapura të zhvilluara nga ekspertët më të mirë në vend e më gjerë. Këtë të mërkurë, analisti shqiptaro-amerikan i çështjeve ballkanike, Agron Alibali mbajti leksionin me temë "Deti Jon si det i paqes dhe delimitimi i hapësirave detare me Greqinë". Vetë studentët e Fakultetit të Drejtësisë në "Luarasi" shfaqën interes për çështjen e diskutuar me ekspertin për paktin detar dhe zhvillimet më të fundit mbi negociatat e reja. "Tematika e leksionit është një paraqitje, një trajtim i problematikës së delimitimit në hapësirat ujore që i takojnë detit Jon dhe detit Adriatik. Një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të ishujve, nëse ata përbëjnë ose jo rrethana të posaçme. Gjithçka u paraqit në përputhje me parimet dhe normat e Konventës për të Drejtën Ndërkombëtare të Detit dhe çfarë të drejtash i takojnë Shqipërisë si vend bregdetar dhe shteteve kufitare si Mali i Zi, Italia dhe Greqia, në kuadrin e delimitit të ujërave", tha analisti Agron Alibali.

## PËRSHTYPJET MBI "LUARASIN"

Më tej ky i fundit tregon se në leksion janë ndërthurur me së miri analiza teorike me trajtimin praktik mbi marrëveshjet për detin. Ai e vlerëson "Luarasin" si një universitet që ndjek fuqishëm traditën e cilësisë dhe profesionalizmit. "Është një bashkim i analizës teorike me trajtimin praktik për sa i takon marrëveshjeve që janë lidhur dhe ato që po diskutohen. Me universitetin "Luarasi" kemi lidhje të ngushta. Është një universitet që e ruan traditën e fuqishme të cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen e studentëve në të ardhmen", thekson analisti. Zhvillimi i leksioneve të hapura është një praktikë e mirë-menduar nga stafi akademik i "Luarasit". Praktika të tilla bashkëkohore synojnë të sjellin te studentët eksperiencat më të mira, duke përgatitur kështu liderët e së ardhmes në tre-



Dje në universitetin 'Luarasi' gjatë leksionit të hapur

gun e punës.

## TRADITA

Vetëm disa ditë më parë,

në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, Besmir Semanaj, ek-

spert dhe menaxher në kompaninë e telekomunikacionit 'Albtelecom' trajtoi

## ANALISTI

"Është një bashkim i analizës teorike me trajtimin praktik për sa i takon marrëveshjeve që janë lidhur dhe ato që po diskutohen. Me universitetin 'Luarasi' kemi lidhje të ngushta. Është një universitet që e ruan traditën e fuqishme të cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen e studentëve në të ardhmen", thekson analisti.

tema të ndryshme mbi teknologjinë me studentët e vitit të parë Bachelor. Eksperti i teknologjisë, tha se studentët shfaqën interes gjatë gjithë orës së leksionit të hapur. Ai shprehet i kënaqur mbi faktin se "Luarasi" nuk garanton vetëm diplomën në përfundim të studimeve, por formon profesionistë të aftë në tregun e punës. Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në "Luarasi", Indrit Baholli theksoi se nëpërmjet praktikave të tilla studentët përgatiten më së miri për tregun e punës. Ai shtoi se leksionet e hapura do të vijojnë përgjatë gjithë vitit akademik, duke ofruar për studentët eksperiencat më të mira.

## Veliaj: Dhjetori, muaji i solidaritetit

### Tirana dhuron ushqime dhe veshje për familjet në nevojë

Si çdo vit, në muajin Dhjetor Bashkia e Tiranës organizon një sërë nismash për t'i gjendur më pranë me një vakt të ngrohtë, ushqime dhe veshje. Ndaj në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, fëmijë të grupmoshave të ndryshme dhe qytetarë iu bashkuan Bashkisë së Tiranës, duke dhuruar lodra dhe veshje, të cilat do të dërgohen pranë qendrave sociale, kopështeve dhe shkollave. Ndërkohë, aktivitetet vijuan më tej me drekën në qendrat sociale. "Tirana vërtetë ka 1 milion



halle, por ka edhe 1 milion mundësi për të qenë solidarë, bashkëpunues dhe ndihmues. E kemi kthyer në traditë në Tiranë, muaji

dhjetor është "Muaji i solidaritetit". Besoj se me kaq shumë dashuri sa ka ofruar Tirana këtë vit, edhe në dhjetor, duke parë sesi

## AKTIVITETET

Në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, fëmijë të grupmoshave të ndryshme dhe qytetarë iu bashkuan Bashkisë së Tiranës, duke dhuruar lodra dhe veshje, të cilat do të dërgohen pranë qendrave sociale, kopështeve dhe shkollave. Ndërkohë, aktivitetet vijuan më tej me drekën në qendrat sociale.

po përfshihen edukatorët, mësueset, punonjëset sociale, që t'i mësojnë fëmijët që të vegjëll me ndjenjën e solidaritetit, do kemi një muaj të bekuar festash dhe ndihme, për të gjithë ata që kanë nevojë", deklaroi Veliaj. Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një tjetër nismë, e cila synon mbrojtjen e mjedisit dhe në të njëjtën kohë t'u vijë në ndihmë personave në nevojë. Në disa prej rrugëve kryesore të qytetit janë vendosur kosha të posaçme me ngjyrë të verdhë, ku të gjithë qytetarët mund të drejtohen për të dërguar rrobata e tyre dhe për të ndihmuar njerëzit në nevojë.

## BUXHETI REKORD INVESTIMET E TAKSAT

'Monitor': Në dispozicion të bashkisë rreth 18.3 miliardë lekë, ose 145 milionë euro

# Buxheti afatmesëm, taksa e ndërtesës 4 herë më e lartë

*Sa do paguajmë për parkimin, hapësirën, pastrimin...*

Bashkia e Tiranës ka hartuar programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2019-2021. Sipas relacjonit, që pritet të diskutohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak, të ardhurat që pritet të mbledhë vetë Bashkia pritet të arrijnë në 13.4 miliardë lekë (ose rreth 105 milionë euro). Me një rritje prej 3% në raport me pritshmërinë e 2018-s. Së bashku me fondet e pakushtëzuara që merr nga qeveria qendrore, buxheti në dispozicion të bashkisë pritet të arrijë në 18.3 miliardë lekë, ose 145 milionë euro, duke arritur në një nivel historik rekord. Edhe për periudhën 2020-2021, të ardhurat e veta të Bashkisë pritet të qëndrojnë në të njëjtat nivele (rreth 13.4 miliardë lekë), ndërsa fondet nga qeveria priten në rënie, çka bën që buxheti total në 2020-n të zbrisë në 16.4 miliardë lekë, ose 10% më pak sesa në 2019-n. Tre taksat e tarifit që pritet sjellin më shumë të ardhura në buxhetin e Bashkisë janë taksa e ndikimit në infrastrukturë (30%), e ndërtesës (17%) dhe tarifat e pastrimit (15%).

### TAKSA E NDRËTESËS

Taksa e re e ndërtesës, për të familjet do paguajnë katër herë më shumë deri në 2021. Për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për banim, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, aplikimi i taksës sipas sistemit mbi bazë vlere, do të fillojë në janar 2019. Sipas relacjonit, për Bashkinë e Tiranës do të vijojë të jetë Drejtoria e Taksave Vendorë, struktura që do të arketojë detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë së Tiranës, ndërsa për detyrimet e kategorisë familjare do të përzgjidhet Agjenti Tatimor brenda muajit dhjetor 2018, nëpërmjet vendimit të posaçëm për këtë qëllim. Në vitin 2019, të ardhurat nga taksa e ndërtesës janë parashikuar në vlerën 2.4 miliardë lekë, nga 1.78 miliardë lekë që është pritshmëria për 2018-n, me një rritje prej 34%. Pas taksës së infrastrukturës, ky është zëri i dytë që sjell më shumë të ardhura në buxhet, me rreth 18% të totalit. Rritja më e ndjeshme parashikohet për familjarët, nga 220 milionë lekë, që pritet të mbledhen në 2018-n, në 510 milionë lekë në 2019-n, edhe në vitet e ardhshme, faturo do të jetë gjithnjë e më e shtrenjtë, pasi të ardhurat nga kjo taksa nga familjarët pritet të arrijnë në 900 milionë lekë në 2021, me një rritje më shumë se 4 herë,



në raport me atë që pritet të paguajmë deri në fund të këtij viti.

### NDËRTIMET

Vrulli i ndërtimeve pritet të vijojë edhe në 2019-n. Bashkia Tiranë parashikon që të mbledhë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit rreth 4 miliardë lekë, me një rritje prej 8% në raport me atë që pritet të mbledhet në 2018-n. Kjo taksa, e cila u rrit me një vendim të vitit 2015, nga 4% e koston në 8% të çmimit

i të shitjes për apartamentet e banimit, i siguron bashkisë rreth 30% të të ardhurave të veta. Bashkia thekson në relacjon se në bazë vjetore, volumi i ndërtimit nuk ka ndryshime të theksuara nga viti 2017. Madje është i krahasueshëm me arkëtimin faktik të kësaj takse në vitin 2014. Pra, këto të ardhura janë gjenues nga ndryshimi i bazës së taksueshme. Po sipas relacjonit, kjo taksa nuk ka ndikuar as në sh-

trenjtimin e apartamenteve, "por ka ulur deri diku fitimin e zhvilluesve, por jo aq sa të disincentivojë apo ulë interesin e tyre për zhvillim". Bashkia thotë se do të ketë ndërtime të reja në zonën e Bulevardit të Ri. "Suksesi i mbledhjes së kësaj takse edhe në vitin 2018 duke patur parasysh se çmimet të qytetit e Tiranës nuk janë rritur, por kanë mbijetuar krahasueshmërisht të njëjta, tregon se kjo taksa nuk ka patur asnjë impakt të qytetari, por ka ulur deri diku fitimin e zhvilluesve, por jo aq sa të disincentivojë apo ulë interesin e tyre për zhvillim. Pra është arritur një balancë midis "vullnetit për të paguar" të biznesit të ndërtimit dhe vullmit të ndërtimit që krijon hapësirë rezidenciale për rreth dhjetëra-mijëra rezidentët e rinj që i shtohen çdo vit Tiranës. Kjo taksa do të vazhdojë të ruajë këtë nivel arkëtimi në vitet e ardhshme, aq më tepër duke parashikuar zhvillimet e reja që pritet t'i shtohen Tiranës në zonën e mirëplanifikuar të Bulevardit të Ri, ku këtë vit u miratua edhe

Plani i Detajuar Vendor nga Këshilli Kombëtar i Territorit - plan ky që i hap rrugë zhvillimit", thuhet në relacjon.

### PARKIMI

Taksa parkimi në kryeqytet bëhet gjithnjë e më shumë një mision i vështirë, ai është dhe më i shtrenjtë. Në 2018-n, përdoruesit e automjeteve kanë paguar 440 milionë lekë (3.5 milionë euro) për të parkuar. Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2018 ka një rritje të ndjeshme kryesisht nga pagesat e parkimit (të ardhurat) me SMS, si rrjedhojë e riorganizimit të strukturave, mënyrës së arkëtimit dhe evidentimit në kohë të përdoruesve të parkimit në rrugët me pagesë, por dhe në sheshet e miratuara për parkim, thuhet në relacjonin e bashkisë. Në 2019-n, bashkia pret të arketojë 420 milionë lekë nga parkimi, me një rënie të lehtë të raport me pritshmërinë e këtij viti. (Monitor)

### Projektet kryesore në shkollë dhe infrastrukturë, ja parashikimi

Në projektet kryesore janë ndërtimi i 17 shkollave me partneritet publik privat, të ndarë në 4 lote, sipas zonave gjeografike. Sipas relacjonit, aktualisht ka përfunduar procesi i përzgjedhjes dhe është lidhur kontrata për fillimin e punimeve për Lotin 1, i cili parashikon ndërtimin e pesë shkollave të reja, tre 9-vjeçare dhe dy të mesme, në Njësitë Administrative Nr.9 dhe Nr.11. Gjithashtu, kanë filluar procedurat e konkurrit për tre lotet e tjera, për të cilat pritet fillimi i punimeve brenda vitit 2019. Tjetër projekt është pylli orbital, që planifikon mbijelljen e 2 milion pemëve në këtë brez të ri të gjelbër të qytetit. Rrjeti Minimal i Bicikletave krijon një skel-et me korsi të dedikuara dhe të veçuara nga trafiku për qytetarët që përdorin bicikletën si mjetin kryesor të lëvizjes së përditshme. Terminali perëndimor parashikohet të përballojë fluksin e autobusëve dhe furgonëve që hyjnë në Tiranë nga qytetet jugore, vërejtore dhe veri-lindore. Për këtë terminal, pas përfundimit të procesit të negociimit, është miratuar tashmë në parim nga Këshilli Bashkiak kontrata koncesionare dhe është në fazën e nënshkrimit. Plani i ri i Përgjithshëm Vendor i Tiranës parasheh një qytet me 5 qendra të reja urbane në Kombinat, Kinostudio, Laprakë, tek Bulevardi i ri si dhe në Shkozë. Ndërtimi i Bulevardit Verior të Tiranës dhe Punimet Civile Përkatesë, Rehabilitimi i Lumit të Tiranës, Kopshiti Zoologjik, transformimi i Piramidës në një qendër që përzien artin, kulturën, teknologjinë e informacionit dhe edukimin, janë disa nga projektet e tjera.

### TAKSAT E TJERA KRYESORE

- Nga taksa e tabelës pritet të arketohen 400 milionë lekë në 2019-n, me rritje 15% me bazë vjetore;
- Taksa e arsimit do t'i sjellë bashkisë 860 milionë lekë në 2019-n, 36% e së cilës do të paguhet nga familjarët dhe pjesa tjetër nga biznesi.
- Nga taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme pritet të arketohen rreth 300 milionë lekë, pa ndryshime nga një vit më parë.
- Nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave pritet të mbledhen rreth 2.1 miliardë lekë, duke qenë zëri i tretë më i rëndësishëm pas taksës së infrastrukturës, që i siguron më shumë të ardhura Bashkisë. Në raport me 2018-n, bizneset dhe familjarët do të paguajnë 7% më shumë.
- Si tarifa për zënien e hapësirave publike, bizneset do të paguajnë 420 milionë lekë, 19% më shumë se ky vit që po mbyllet.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 14,760,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparaksh pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përsëritje: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 28 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shpëllim në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Aparatament Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Lushë, Komuna Dajt, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 19,516 Euro. Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 10.12.2018.

Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiffs Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



## LAMTUMIRA E FUNDIT PRESIDENTI I 41 I SHBA-ve

Amerikanët i dhanë lamtumirën ish-Presidentit të 41-të të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George H.W. Bush, i ndarë nga jeta të premtën e kaluar në moshën 94-vjeçare. Në ceremoninë e zhvilluar në Capitol, morën pjesë figurat më të lartë të shtetit, mes tyre edhe Presidenti Donald Trump dhe Zonja e Parë Melania. Trump bëri homazhe përpara arkivolit të Bushit, të mbuluar nga flamuri amerikan. Mediave nuk u shpëtoi as mallëngjimi i djalit të George H.W. Bush, presidentit të 43-të, George H.W. Bush. Flamujt amerikanë qëndrojnë prej së shtunës në gjysmë shtizë, në nderim të ish-presidentit. Ish-senatori Bob Dole ka nderuar Presidentin e ndjerë George H.W. Bush, duke u ngritur nga karrigia me rrota. 95-vjeçari u ndihmua që të ngrihej dhe të qëndronte përpara arkivolit të mikut dhe dikur rivalit të tij, duke i bërë të gjitha nderimet si një veteran i Luftës së Dytë Botërore. Capitol-i ishte i hapur për personalitetet dhe publikun deri të mërkurën në mëngjes për të nderuar presidentin e 41-të amerikan. Ai vdiq në shtetin e tij Teksas të premtën e 30 nëntorit në moshën 94 vjeçare, pas një sëmundjeje që i zgjati disa vite. Ish-Presidenti u për-coll nga Teksasi me 21 të shtëna topash dhe u transportua për në kryeqytetin amerikan me avionin presidencial që u vu në dispozicion nga presidenti Donald Trump. George H. W. Bush, i cili shërbeu një mandat të vetëm në Shtëpinë e Bardhë nga 1989 në 1993, do të nderohet me një funeral shtetëror të mërkurën në Katedralet Kombëtare të Uashingtonit dhe shumica e zyrrave qeveritare do të qëndrojnë të mbyllura atë ditë. Varrimi do të bëhet ditën e sotme në bibliotekën e tij presidenciale në Teksas. Presidenti i SHBA, Donald Trump do të marrë pjesë në funeral. Të hënën ai shkruante në Twitter: "Do të jem me familjen Bush për t'i bërë homazhet e mia Presidentit Xhorxh H.W. Bush". James Baker, ish-sekretar i shtetit gjatë presidencës Bush dhe mik i tij prej 60 vjetësh, i tha rrjetit CNN të dielën se ai e konsideronte zotin Bush si "njeriun më të sjellshëm dhe më të kujdesshëm për tjetrin që kishte njohur." Ai tha se "shëndeti i tij u keqësua shumë" në muajt e fundit, por ai ishte në gjendje të bisedonte me telefon me fëmijët e tij të rritur; përfshirë ish-presidentin George H.W. Bush. Zoti Baker tha se fjalët e fundit të ish-presidentit Bush ishin: "Edhe unë të dua", kur iu drejtua presidentit Bush i ri, presidenti i 43-të të vendit. Sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë Sarah Sanders tha në një deklaratë se e mërkura është caktuar si ditë kombëtare zije dhe se flamujt e

5 dhjetori ditë zie në Amerikë, për shtatë ditë nderohet në Capitol presidenti i 41 i SHBA-ve

# Përcillet në banesën e fundit George H. W. Bush

## Homazhe për ish-presidentin në Uashington



Presidenti

### XHORXH H W BUSH

Amerikanët i dhanë lamtumirën ish-Presidentit të 41-të të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George H.W. Bush, i ndarë nga jeta të premtën e kaluar në moshën 94-vjeçare. Në ceremoninë e zhvilluar në Capitol, morën pjesë figurat më të lartë të shtetit, mes tyre edhe Presidenti Donald Trump dhe Zonja e Parë Melania. Flamujt amerikanë qëndrojnë prej së shtunës në gjysmë shtizë, në nderim të ish-presidentit.

## Flamuri kombëtar në gjysmështizë, Meta: Nderim për George H.W. Bush

Presidenca ditën e djeshme ka ulur flamurin kombëtar në gjysmështizë në nderim të mirënjohje të George H.W. Bush, që ndërroi jetë 4 ditë më parë. "Në nderim të mirënjohje të veprës së vyer të Presidentit të 41 të SHBA-ve, George H.W. Bush ndaj ndryshimeve të para demokratike në Shqipëri e qëndrimit të tij të palëkundur për liritë e të drejtat e shqiptarëve, veçanërisht në Kosovë, në vlerësim e respekt të thellë ndaj betejës së tij të palodhur për lirinë dhe shembjen e Murit të Berlinit, Flamuri Kombëtar në In-

stitucionin e Presidencës është ulur sot në gjysmështizë". shkruan Presidenti Ilir Meta. George Herbert Walker Bush lindi më 12 qershor 1924. Ai ishte veterani i fundit i Luftës së Dytë Botërore që shërbente si president. Bush ka qenë drejtor i CIA-s, i dërguar i SHBA në Pekin, kongresmen republikan, nën-president dhe më pas President nga viti 1989 deri në 1993. George H.W. pasoi në Shtëpinë e Bardhë Ronald Reagan. Bush shpesh njihet si "George H.W. Bush", "Bush 41", "Bush Plaku", apo "George Bush Sr." për ta dalluar nga djali George W. Bush.

Jo vetëm për diplomacinë në Luftën e Ftohtë dhe në kohën e rënies së Murit të Berlinit, por George H. W. Bush do të mbetet në memorie për shqiptarët edhe për mesazhin e tij në 1992 për Slllobodan Millosheviç ku e paralajmëronte se në rast të një konflikti në Kosovë SHBA do të jenë gati të përdorin forcën ushtarake. "Në rast se në Kosovë shkaktohet konflikt nga veprimet e Serbisë, Shtetet e Bashkuara do të jenë të gatshme të përdorin forcë ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në Serbi", deklaronte Bushi asokohe.

## Fatmir Mediu në homazhe

Kreu i PR, Fatmir Mediu kishte i pranishëm në homazhet e zhvilluara në Kongresin Amerikan për Presidentin George H.W. Bush. "Të gjithë i janë mirënjohës këtij presidenti të madh, i cili mbështeti luftën kundër komunizmit dhe vendosjen e demokracisë në Europën Juglindore dhe në Shqipëri. Presidenti Bush mbështeti demokracinë në Shqipëri nëpërmjet IRI, zhvilloi një marrëdhënie të veçantë me Presidentin Berisha gjatë kohës kur ishte President dhe më pas. Për herë të parë ai priti në Shtëpinë e Bardhë një president shqiptar" - shkruan Mediu në Facebook.

## Biden, kandidat për president

Kur duhen edhe 2 vjet nga zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara, gara për të nxjerrë nga Shtëpia e Bardhë Donald Trumpin, duket se po merr formë. Ish-zv/Presidenti amerikan Joe Biden me gjasë do të shpallë kandidaturën e tij për presidencialet 2020. Gjatë prezantimit të librit të tij, ish-zëvendësi i Barak Obamës lëshoi një deklaratë që la shijen e kandidaturës në mediat amerikane. Ish-numri 2 i Shtëpisë së Bardhë, me një karrierë të gjatë në politikë, përfillet prej kohësh si kandidat i demokrateve për president. Nga ana tjetër, në radhët e republikanëve, Presidenti Donald Trump e ka shprehur hapur që do të kërkojë një mandat të dytë, ndërsa përfillet, gjithashtu, për një zv/president, pikërisht ai aktual, Mike Pence, i cili për nga figura dhe pëlqimi në publik, shihet si kandidat potencial për të pasuar shëfën e tij.

### JAMES BAKER

"Zoti Bush ishte njeriu më i sjellshëm dhe më i kujdesshëm që kam njohur. Shëndeti i tij u keqësua shumë në muajt e fundit, por ai ishte në gjendje të bisedonte me telefon me fëmijët e tij të rritur, përfshirë ish-presidentin George W. Bush. Fjalët e fundit të ish-presidentit Bush ishin: 'Edhe unë të dua', kur iu drejtua presidentit Bush i ri, presidenti i 43-të të vendit", tha ish-sekretari i shtetit, James Baker.



Shtëpisë së Bardhë tashmë janë ulur në gjysmë shtizë, për të nderuar ish-presidentin e ndjerë. Tradicionalisht, fu-

neralet shtetërore në SHBA mbahen për presidentit, ish-presidentit apo zyrtarët e tjerë sipas vendimit të presidentit.

Një funeral shtetëror zgjat shtatë deri në dhjetë ditë dhe përbëhet nga tri faza: ceremonitë në shtetin përkatës, cere-

monitë në Uashington, dhe ceremonitë në shtetin ku individ i ka zgjedhur për t'u varrosur.

Rrëfihet modeli: Oferta më tunduese do ishte të dilja në kopertinën e "Vogue"

# Kevin Kola:

## Akademia e modës në Belgjikë, bashkëpunimet me të famshmit, ja si e drejtoj

*"Dua të krijoj një platformë për të ndihmuar të rinjtë shqiptarë"*

Egla Xhemali


**M**odelingu është rruga që ndjekin ata që e duan të bukurën dhe që punojnë fort për të arritur objektivat e tyre. Nuk është e lehtë që nga model, të drejtosh e të trajnosh të rinj për t'u bërë pjesë e pasarelave të mëdha, për më tepër përtej kufijve. Asgjë nuk është e pamundur. Në një rrëfim për "Gazeta shqiptare", Kevin Kola na tregon për pasionin dhe profesionin e tij, eksperiencat më të veçanta që ka përjetuar, akademinë që ka rezultuar e suksesshme në Belgjikë, ku ai drejton dhe trajnon të rinjtë që duan t'i hyjnë botës së modelingut. Ai pohon se vizita e personaliteteve ndërkombëtare të modës dhe masterclasset që ofrojnë për studentët janë ditët më të bukura. Nuk ka ndonjë kriter në përzgjedhjen e modeleve, pasi gjithkush që e do këtë fushë, interesohet që të trokasë aty ku dyert ngelen të hapura dhe ku i ofrohet mundësia për të realizuar ëndrrën. Më tej, Kola foli për ofertën më tunduese që mund t'i vijë një modeli si dhe objektivat që do të realizojë. Ne i urojmë shumë suksese akademisë dhe Kevin Kolës për këtë projekt gjigant, që u vjen në ndihmë të gjithë atyre që e duan modelingun!

**Ju keni qenë model. Ka qenë e vështirë të ushtronit profesionin tuaj?**

Në Shqipëri po, jashtë Shqipërisë jo. Kërkesa dhe vizioni i "profesionistëve" shqiptarë ndalon te një vajzë dhe një djalë i bukur. Modelingu është shumë më shumë se aq. Duke filluar nga detajet që e bëjnë një model unik, pasioni, karakteri dhe energjia që përcjell me gjuhën e trupit, kreativiteti dhe disiplina janë të gjitha elementët që një model/e i/e vërtetë duhet të ketë. Fatkeqësisht Shqipëria nuk i ka.

**Mendoni se diskriminohen djemtë që dalin nëpër pasarelë?**

Çdo vit më pak se vitin e kaluar. Me kalimin e kohës, dalja në pasarelë e një modeli



mashkull nuk është më problem ose tabu. Dikur konsiderohej veprim "gay", sepse moda është një industri që lindi me tendencë nga gjinia femërore.

**Ekspierienca më e veçantë që mbani mend?**

Ka shumë, por më e veçanta ndodhi së fundmi. Lançimi i akademisë që aq shumë e kam ëndërruar, më në fund u bë.

**Tanimë ju drejtoni një akademi modelingu në Bel-**

**gjikë, ku dhe si do t'i trajnoni të rinjtë që duan t'i hyjnë kësaj rruge. Cila është e veçanta e saj?**

Akademia si vendndodhje është në dalje të kryeqytetit belg, në ambientet e AED, studios e cila është një kompani që xhiron dhe prodhon skenat e efekteve speciale dhe televizive për Hollywood dhe shumë televizione europiane. Për shkak të vendndodhjes, të rinjtë kanë shumë hapësirë dhe mundësi



si të trajnohen dhe mësojnë. Më e veçanta është gjithnjë vizita e personaliteteve ndërkombëtare të modës dhe masterclasset që ata ofrojnë për studentët. Ato ditë janë gjithnjë më të bukurat.

**Nga çfarë kriteresh nis përzgjedhja e modeleve?**

Akademia ime nuk ka kriter. Me kalimin e viteve pasarelave po lejojnë kalimin e shumë moshave, stileve, masave trupore dhe për këtë arsye, programi im studimor është

përshtatur në një kusht të vetëm: pasionin e atij që ndjek mësimin dhe dëshirën për të ecur përpara.

**Oferta më tunduese që mund të marrë një model?**

Personalisht, oferta më tunduese do ishte të dilja në kopertinën e "Vogue". Nuk ka për të ndodhur, por më lejohet të ëndërroj pak herë pas here (qesh).

**Pakti më i rrezikshëm që keni bërë për hir të punës?**

Për të hapur akademinë dhe

përballuar vështirësinë vura në vijë gjithçka kisha. Një lëvizje e gabuar dhe gjithçka do merrte fund.

**Keni menduar ndonjëherë të hiqni dorë nga puna juaj?**

Shumë herë. Nuk i numëroj dot.

**Cilat janë objektivat që doni me doemos t'i realizoni?**

Synimi aktual është krijimi i një platforme të rregullt dhe të mirë, ku vajza dhe djem nga Shqipëria mund të shihen dhe vlerësohen më shumë.





## Dafina Zeqiri "djeg" rrjetet sociale me imazhe provokuese

Këngëtarja e njohur Dafina Zeqiri, pas shumë angazhimeve me projekte dhe koncerte të shumta ka udhëtuar drejt ishujve Maldive për të shijuar disa ditë pushimi. Dafina po qëndron atje së bashku me nënë dhe motrën, ndërsa nuk kanë munguar edhe fotot tejet tërheqëse në bikini. Edhe këtë herë, Dafina ka sjell imazhe të reja nga ishulli përrallor duke shfaqur linjat perfekte që çdo kush do t'i dëshironte. Këngëtarja dukej 'përvëluese' dhe tejet tërheqëse me fotot që ka bërë publike në profilin e saj në "Instagram".



## Sherri mes Beatrixit dhe Anxhelinës, zbuloni kush u bë shkak

Ishte ditëlindja e Anxhelinës ajo që zbuloi se midis dy kushërirave marrëdhëniet nuk janë më si më parë. Kështu disa ditë më parë u përhap lajmi se Beatrix dhe Anxhelina nuk flasin pas një sherri mes tyre. Madje ato as nuk e ndjekin më njëra-tjetrën në rrjetet sociale. Burime bënë të ditur se shkak është grimieri i njohur Ariel, shkruan 'Iconstyle'. Arieli është i njohur në SHBA dhe njihet për miqësinë me familjen Kardash-ian. Beatrix i ka kërkuar atij ta ndihmojë për t'i hapur mundësinë të reja për në Los Angeles. Kjo gjë nuk i ka pëlqyer Anxhelinës, e cila është mikeshë e ngushtë me Arielin dhe qëndrojnë prej vitesh në një shtëpi me të prej. Kështu mes dy kushërirave raportet janë prishur.



## Marina bëhet xhelozë për Luanën: Veç një të keqe ka...

Moderatorja e njohur Marina Vjollca ka treguar se është xhelozë për Luanën. Sot janë dy moderatore mjaft të dashura dhe pa asnjë dyshim motrat më joshëse në Shqipëri. Marina këtë sezon televiziv është shkëputur nga televizioni kurse Luana vazhdon më emisionin e saj çdo të shtunë ku është dhe moderatore 'Shiko kush luan'. Dy moderatore na kanë treguar gjithmonë se kanë një dashuri të madhe dhe janë shumë të lidhura njëra me tjetrën. Së fundmi, Marina në një postim në profilin e saj në "Instastory" ka treguar se është xhelozë për Luanën. Ajo ka nxjerrë një kolazh me foto të Luanës dhe motrës së tyre të madhe Lira. Motra e tyre, Lira, ka të preferuar Luanën dhe jo Marinën, dhe këtë ajo e ka bërë publike. "Veç një të keqe ka Lira, ka të preferuar Luanën", shkruan Marina duke e shoqëruar me disa emoji me nerva.



## Era Istrefi na bën krenarë, këngëtarja do pushtojnë botën në 2019

Këngëtarja Era Istrefi po njihet prej kohësh vetëm rritje në karrierën e saj. E fundit që ka shkruar për të është 'Politico.eu' një media me shumë rëndësi, sidomos në aspektin politik. "Era Istrefi po e fut Kosovën në hartë edhe pse disa nuk duan që të jetë aty. 24-vjeçarja nga Prishtina ka shijuar suksesin internacional. Muzika dhe stili i saj janë krahasuar me Rihannën dhe Sian shumë herë. Albumin e parë pritet ta publikojë në 2019-ën. Teksa e sheh, kupton ajo ka gjithçka i duhet një ylli pop-i, e re, tërheqëse, e bukur. Megjithatë karriera e saj nuk ka lidhje me politikën, beteja që ajo po bën për të ardhmen e Kosovës, e cila para pak kohësh për pak i shkatërroi pjesëmarrjen në 'Kupën e Botës', pasi Rusia nuk e njeh Kosovën dhe nuk e lejoji të hynte në territorin e saj me pasaportën e vendlindjes, është e vazhdueshme", shkruan prestigjiozja. Ata theksojnë se Era do të pushtojë botën me këngët e saj gjatë 2019-ës dhe e kanë emëruar ambasadorën e pop-it. Krahas Erës, në shkrim përmendet edhe Rita Ora dhe futbollisti Xherdan Shaqiri, për rolin e tyre në botë.



## IN MEMORIAM

# Vdekja e Kristian Gyt, humbje e madhe për kulturën shqiptare

Rexhep QOSJA

*Albanologu francez ka përkthyer Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe disa vepra shkrimtarësh*

U nda nga jeta albanologu Kristian Gyt. U nda nga jeta në moshën 87-vjeçare, por u nda nga jeta duke mbetur i përvetshëm dhe i lavdishëm në historinë dhe kulturën shqiptare.

Studiuesit e shquar Remzi Përnaska dhe Enver Hysa kanë sjellë shumë të dhëna për jetën e tij, për natyrën e tij, për krijimtarinë e tij shkencore, për angazhimet e tij të gjithanshme kulturore, shoqërore dhe institucionale, në përgjithësi për përkushtimet e tij ndaj njësore e mendore. Prej këtyre të dhënave shihet se Kristian Gyt ka qenë ose drejtues, ose pjesëmarrës i shumë institucioneve, i shumë organizatave dhe i shumë shoqatave të Francës, në të cilat është punuar dhe punohet për historinë e Shqipërisë e të popullit shqiptar, për kulturën dhe qytetërimin shqiptar.

E gjithë përmbytja e veprimtarisë dhe e krijimtarisë së tij të gjatë, shumëvjeçare, që përbën qëllimin kryesor të studimeve të tij të gjithanshme, janë historia, gjuha, zakonet, traditat, folklori, letërsia e popullit shqiptar.


Kristian Gyt ishte njëri prej njohësve më të mirë dhe njëri prej trajtuesve më të gjithanshëm të gjithë atyre vlerave që përbënin të kaluarën dhe të atyre që përbëjnë të përtrashmen shpirtërore shqiptare.

Për shkak se e ka njohur aq gjithanshëm dhe e ka trajtuar aq përkushtueshëm historinë e popullit shqiptar, për shkak se e ka njohur dhe e ka trajtuar aq gjithanshëm krijimtarinë e tij shpirtërore, Kristian Gyt e ka dashur popullin shqiptar.

Dhe, për shkak se e ka dashur aq përkushtueshëm popullin shqiptar ai ka marrë pjesë me punë, me veprimtari shoqërore e kulturore, me studime shkencore kudo është folur për të: në tubime të ndryshme, në sesione, në simpoziume, në konferenca e në kongrese shkencore albanologjike, ballkanologjike, evropiane e botërore.

Për shkak se e ka dashur aq përkushtueshëm popullin shqiptar ai e ka përkthyer Kanunin e Lekë Dukagjinit. Dhe, për të njëjtat arsye, ai ka përkthyer vepra letrare, studime e trajtesa shkencore të autorëve shqiptarë.

Sa shumë të dhënat e reja, sa shumë gjykimet e reja, sa shumë vlerësime të reja janë të përmbytura në studimet dhe në përgjithësi në shkrimet e në ligjëratat e tij për historinë shqiptare, për gjuhën shqipe, për zakonet, adetët, kanunet, në



Librat e përkthyer nga Kristian Gyt

përgjithësi për krijimtarinë shpirtërore të popullit shqiptar.

Është dukshëm e qartë se Kristian Gyt ka shkruar shumë në sasi e me shumë cilësi për ne, për shqiptarët, por ne jo sa duhet dhe sa e ka merituar kemi shkruar e bërë për të.

Shumësia e lëndëve, e temave, e çështjeve, e problemeve që ka trajtuar ai në studimet e tij shqiptare ka merituar shumë më tepër kujdes, paraqitje e popullarizim prej nesh.


Përkushtimi ynë si popull e si shtete ndaj gjithë veprimtarisë së tij, ndaj gjithë krijimtarisë së tij mendore, ndaj gjithë studimeve të tij shqiptare nuk do të ishte vetëm

shprehje e nderimit tonë për të, për Veprën e tij të madhe albanologjike, por edhe nevojë mendore e morale e kohës sonë për atë Vepër e për atë intelektual francez, evropian, botëror.

Studiuesit e historisë dhe kulturës shqiptare si Kristian Gyt, miqtë e përkushtuar si Kristian Gyt, albanologët e shquar si Kristian Gyt gjithmonë e kanë nderuar dëshmueshëm dhe gjithmonë e kanë dashur dëshmueshëm popullin shqiptar me dhembjet, me ideat e me të arriturat e tij.

E duan, natyrisht, dukshëm dhe sot.

Nderimi ynë për ta, përkushtimi



ynë ndjenjor e mendor ndaj tyre duhet të jetë gjithnjë e më i dukshëm, më mbarekombëtar.

Për të gjitha arsyet e sipërthëna nderimi ynë, kujtimi ynë për albanologun e madh, për mikun tonë të madh Kristian Gyt do të jetë i përvetshëm. I përvetshëm dhe i dësh-

muar me përkushtime konkrete historike, shkencore, shtetërore.

Me familjen e tij, me miqtë, bashkëpunëtorët dhe me të gjithë ata që e kanë dashur e çmuar; unë, si mik dhe adhurues i Veprës së tij, i Etikës së tij intelektuale, ndaj dhembjen dhe pikëllimin.

Fatmira Nikolli

Më datë 3 dhjetor 2018, në Galerinë Kombëtare të Arteve ka ardhur nëpërmjet shërbimit postar një zarf nga qytetari Armando Luaj. Specialistja e protokollit pasi ka hapur zarfin ka identifikuar një objekt në formën e një plumbi të vendosur në një letër transparente. Për këtë arsye, zarfi është mbyllur përsëri, dhe institucioni ka bërë një kallëzim në polici në datën 4 dhjetor. Policia po bën verifikimet përkatëse për çështjen". Ka qenë kjo përgjigja që zyra e shtypit të Galerisë Kombëtare të Arteve i ka dhënë "Gazetës Shqiptare", pas i është kërkuar konfirmim për ngjarjen.

Sqarimi nga ana e institucionit ka qenë i shkurtër, megjithatë ata janë përgjigjur për sa më sipër.

NJË JAVË MË PARË

Një letër që në pamje të parë është e tejdukshme dhe një plumb. Nuk është vetëm (as) një vepër arti. Artisti shqiptar Armando Lulaj i ka

dërguar një plumb në zarf më 29 nëntor Muzeut të Arteve të Bukura, ose ish-Galerisë së Arteve Kombëtare në Tiranë. Lajmin e ka konfirmuar vetë ai për "Gazetën Shqiptare". "PLUMB NË ZARF", 2018 ka edhe shpjegimin e vet. "Si i vetmi institucion i rëndësishëm i artit në vend, Galeria Kombëtare e Arteve, sot Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura, është konsideruar historikisht pikë referimi për artistët vendas, sikundër edhe për publikun. Ndërtesa aktuale, e cila ndodhet në Bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', u inaugurua më 29 nëntor 1974, në përvjetorin e çlirimit të vendit. Ky është edhe momenti i parë i riorganizimit dhe ristrukturimit të institucionit, falë të cilit misioni dhe veprimtaria artistike e galerisë vazhdoi shtysën drejt vizionit shtetëror për ndërtimin e të ardhmes socialiste", shënon ai në tekstin që shoqëron imazhet e zarfit në platformën "DebatikCenter".

Artisti, i njohur për veprat e tij vitet e fundit dhe si përfaqë-



## VENDIMI

# Pikëpyetjet e lahutës në UNESCO, reagon Ministria e Kulturës

Serbia regjistron lahutën në UNESCO. Prej ditësh lajmi është shpërndarë në çdo media dhe në rrjetet sociale me vrullin e madh të zhgënjimit për humbjen e "pronësisë" mbi vegël muzikore.

Në listën e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë së paprekshme janë futur edhe 21 elemente të reja, u tha këto ditë, duke bërë me dije se lista është pasuruar edhe me të tjera trashëgimi e pasuri nga vende të ndryshme të botës. Në mesin e kësaj liste është edhe të kënduarit me lahutë nga trevat e Serbisë. Shogërimi me këngë në performimin me lahutë (gusle - në Serbi) është tanimë pjesë e mbrojtjes nga UNESCO. Sipas UNESCO-s, performimi me këngë dhe lahutë është i një rëndësie historike dhe kësaj duhet mbrojtur e promovuar. Serbia, në fakt, ka lobuar shumë që ta fusë lahutën e saj në këtë listë. Në Serbi disa organizata janë bashkuar në Unionin e Lahutarëve të Serbisë dhe kanë organizuar disa festival të Lahutës në Serbi. Regjistrimi është bërë me kërkesë të Serbisë dhe ky është njoftimi në faqen zyrtare të UNESCO-s dhe lajmi është përcjellë me shqetësim në Shqipëri. Pas disa ditësh, ka reaguuar dhe edhe Ministria e Kulturës në Shqipëri, e cila ka treguar përpjekjet që po bën me Malin e Zi për të vijuar "procedurën për zgjerim të pjesëmarrjes në këtë regjistrim edhe të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të Europës Juglindore, që kanë dëshirë t'i bashkohen këtij procesi për këtë aset kulturor specifik".

## REAGIMI I MK

Ministria e Kulturës, në komunikim edhe me Misionin tonë të

*"Jemi në proces me Malin e Zi, për të zbatohet propozimi shumëkombësh"*

Përhershëm pranë UNESCO-s, sqaron se:

- Asnjë vendim nuk është marrë dhe në asnjë rast Komiteti Ndërqeveritar për Ruajtjen e Pasurisë Jomateriale të UNESCO-s nuk është shprehur, siç cilësohet gabimisht në disa media, se "lahuta nuk është shqiptare, por serbe".

- Në sesionin e 13-të të Komitetit Ndërqeveritar për Ruajtjen e Pasurisë Jomateriale u bë regjistrimi i nominimit "Të kënduarit në shogërimin e Gusle" (instrumenti që në shqip quhet lahuta) prezantuar nga Serbia, në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit.

Ministria e Kulturës, ashtu sikurse u theksua edhe në këtë mbledhje nga delegacioni i Shqipërisë, vë sërish në dukje se

o praktika kulturore e "Të kënduarit me lahutë" është historikisht e pranishme dhe është një praktikë kulturore e gjallë në një zonë shumë të gjerë të Evropës Juglindore, jo vetëm në Shqipëri, Kosovë, por edhe në Mal të Zi, në Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, etj.

o të kënduarit me lahutë është nga ato raste kur mund të zbatohet propozimi shumëkombësh bazuar në faktin se ato vende ndajnë praktikën kulturore në fjalë si një traditë historike dhe dukuri kulturore të gjallë, dhe asnjë vend nuk përjas-

hton tjetrin;

o Ministria e Kulturës së Shqipërisë është tashmë në kontakt zyrtar me Ministrinë e Kulturës së Malit të Zi për të vijuar me vullnet të përbashkët procedurën për zgjerim të pjesëmarrjes në këtë regjistrim edhe të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të Europës Juglindore, që kanë dëshirë t'i bashkohen këtij procesi për këtë aset kulturor specifik.

o Çdo vend ndjek prioritetet e ndryshme në punën përgatitore për regjistrimin e pasurive kulturore në listat e trashëgimisë botërore dhe se aktualisht Shqipëria është në fazën përfundimtare procesit të regjistrimit të dosjes së pasurisë kulturore dhe natyrore të pjesës shqiptare të Liqenit të Ohrit në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, ndërkohë që ka në proces përgatitjen e propozimeve për regjistrim në listat përkatëse disa pasuri të tjera materiale dhe jo materiale, si p.sh. Parku arkeologjik i Apolonisë.

Ministria e Kulturës thotë se bashkë me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, në po të njëjtin takim, u miratua kërkesa e Shqipërisë për asistencë ndërkombëtare për projektin e krijimit të Inventarit Kombëtar të Pasurive kulturore jomateriale që do të krijojë një bazë të dhënash në nivel rajonal dhe kombëtar për këtë kate-



gori.

## Plumb në Galerinë Kombëtare të Arteve, kallëzim penal artistit Armando Lulaj

*Zarfi nën hetim, policia nis verifikimet*

bashkëkohor i lajmëruar prej qeverisë socialiste që prej vitit 2013 nuk ka shfaqur ende e nuk mund të shfaqë kurrësi asnjë shpërthim vizionar, asnjë zgjim, e asnjë hapje reale institucionale. Gjurmët që po lënë pas zbulojnë gjithnjë e më shumë drejtimin e kundërt. Institucioni është ngurtësuar e vetëmbyllur, ndërkohë që shpërthimi i vërtetë ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë jashtë tij", thotë Lulaj. Ai shton se "në këto kohë të demokracisë së paqartë dhe të kontrollit total politik mbi artin, në këtë datë historike të çlirimit të vendit nga nazi-fashizmi që përkon me përvjetorin e 44-t të inaugurimit të kësaj godine, i dërgova institucionit një copëz të vogël realiteti". Ai e cilëson "PLUMB NË ZARF", një dhuratë për Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura. Ky akt u vulos dhe u siglue më dt. 29 Nëntor 2018, në orën 09:20, dhe ju dërgua Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura, ish-Galeria Kombëtare e Arteve, me shërbim ekspres të brendshëm postar me nr. EB756471574AA.



Faksimile e postës



Armando Lulaj

sues i Shqipërisë në Bienalen e Venecias(2015), ka një mesazh që përçon me zarfin e fundit. "Në këtë

moment të kohës sonë, kur i gjithë aparati shtetëror aktual shfaqet më se i vendosur, që me çdo

mjet të lançojë vendin drejt bashkëkohores, institucioni më i rëndësishëm i artit, si pasojë e

transformimit të tij në muze, i është nënshtruar një rishtrukturi-mi dhe rindërtimi të dytë. Qëllimi

# Kësti i tretë i dëshmërbimit, emrat dhe dosjet e përfituesve

*Trashëgimtarët e parë dhe të dytë që marrin paratë*

1319	9509	1699	Xhavit Biçaku	ME BURG
1320	9514	1699	Fadil Izeti	DENIM
				KAPITAL
1321	9515	784	Kostandin Tashko	ME BURG
1322	9519	1231	Selim Hasimja	ME BURG
1323	9523	1699	Zylfj Laçka	ME BURG
1324	9524	1699	Gaqo Thoma	ME BURG
1325	9525	707	Shaban Ponari	ME BURG
1326	9538	1699	Muço Çobo	ME BURG
1327	9582	1699	Sulo Malaj	ME BURG
1328	9584	1699	Osman Zuna	ME BURG
1329	9593	1699	Miftar Jegeni	DENIM

Nr. NR	Dosje	VKM	Emer Mbiemer	Tipi Denimit	1249	8755	1699	Guido Xhimitiku	ME BURG	1330	9596	707	Ilia Stavro	ME BURG
1184	8254	707	Ndrec Çupi	ME BURG	1250	8789	1699	Ndue Ulkaj	ME BURG	1331	9605	707	Ali Nezaj	ME BURG
1185	8258	707	Irfan Mujuni	DENIM	1251	8797	1699	Nasir Mezin	ME BURG	1332	9608	707	Xhevdet Hasanaj	ME BURG
				KAPITAL	1252	8799	1699	Gurali Pasho	ME BURG	1333	9634	784	Isuf Kurti	ME BURG
1186	8294	707	Riza Kuçi	ME BURG	1253	8800	707	Bektaş Vesho	ME BURG	1334	9666	707	Hamit Halili	ME BURG
1187	8297	784	Ali Sinomataj	DENIM	1254	8803	784	Demirali Kape	ME BURG	1335	9669	1699	Ejup Kurtulla	ME BURG
				KAPITAL	1255	8805	1699	Bajram Belegu	ME BURG	1336	9697	1699	Kol Sylaj	ME BURG
1188	8314	707	Pjetër Deda	ME BURG	1256	8814	784	Pal Bushi	ME BURG	1337	9719	1699	Faik Tahiraj	ME BURG
1189	8317	707	Malo Hoxhaj	ME BURG	1257	8830	707	Injac Baqli	ME BURG	1338	9734	784	Flamur Xhuli	ME BURG
1190	8322	784	Ndue Shoferi	ME BURG	1258	8876	707	Nazmi Veshi	ME BURG	1339	9736	1259	Uke Avdij	ME BURG
1191	8323	784	Kol Tota	DENIM	1259	8884	784	Yzedin Buzaj	ME BURG	1340	9743	784	Ibrahim Behra	ME BURG
				KAPITAL	1260	8902	784	Mehmet Picari	ME BURG	1341	9748	707	Veli Mulla	ME BURG
1192	8324	707	Zenel Koçi	ME BURG	1261	8903	1147	Shyqri Begolli	ME BURG	1342	9750	707	Sulejman Mulla	ME BURG
1193	8333	1699	Brahim Vuçaj	ME BURG	1262	8926	1699	Gjergji Titani Kostallari	ME	1343	9767	707	Mehmet Rrenjollari	ME BURG
1194	8335	707	Ndue Moli	ME BURG						1344	9780	784	Syrja Lame	ME BURG
1195	8336	1699	Gjelosh Grishaj	ME BURG						1345	9796	1699	Lek Lleshi	ME BURG
1196	8341	1699	Gelo Zharkalli	ME BURG						1346	9797	1699	Ahmet Lusha	ME BURG
1197	8342	1699	Sali Saliaj	ME BURG						1347	9804	707	Shefki Spata	ME BURG
1198	8343	1699	Selam Lutaj	ME BURG						1348	9806	707	Ilia Tarusha	ME BURG
1199	8370	784	Muhamet Tepelija	ME BURG						1349	9816	707	Teofik Bekteshi	ME BURG
1200	8377	784	Ahmet Kurushi	ME BURG						1350	9836	1699	Apostol Mosko	ME BURG
1201	8383	707	Xhabir Mustafaj (Gostvari)	ME BURG	1266	8948	784	Ebahet Bega	ME BURG	1351	9840	1699	Vladimir Dhora	ME BURG
				ME BURG	1267	8961	1699	Mark Shehu	ME BURG	1352	9841	1699	Sherif Qejvani	ME BURG
1202	8385	784	Mit'hat Myftiu	ME BURG	1268	9010	707	Prof. Çoka	ME BURG	1353	9852	1147	Kajmak Bardhollari	ME BURG
1203	8388	707	Dhimitr Gjika	ME BURG	1269	9039	1699	Çesk Barbullushi	ME BURG	1354	9862	707	Gjergji Beleshi	DENIM
1204	8397	1147	Hivzi Goja	DENIM	1270	9045	784	Sulo Murataj (Klosi)	DENIM					KAPITAL
				KAPITAL	1271	9054	1699	Isa Shala	ME BURG	1355	9896	707	Petrit Dume	DENIM
1205	8398	1699	Rushit Çoçoli	ME BURG	1272	9056	1699	Imer Zenelhasani	ME BURG	1356	9908	707	Ndue Uka	ME BURG
1206	8403	1147	Naim Liço	ME BURG	1273	9063	784	Selami Tepelena	ME BURG	1357	9911	1699	Mdaz Verzivolli	ME BURG
1207	8405	1699	Egërem Beliu	ME BURG	1274	9065	784	Isuf Selmani	ME BURG	1358	9970	784	Gëzim Kadesha	ME BURG
1208	8418	1699	Sabri Kapollari(kapa)	ME	1275	9072	1699	Hajdar Fregaj	ME BURG	1359	9992	707	Imer Plaku	ME BURG
				BURG	1276	9079	1259	Zejnel Çela	ME BURG	1360	10000	707	Shefqet Halidri	ME BURG
1209	8437	707	Fadil Plumbi (Hafizi, Ageja)	ME BURG	1277	90								



1397	10344	1699	Thanas Dhimitri	ME BURG	1491	11306	707	Zef Zorba	ME BURG	1588	12752	784	Hito Çakaj	DENIM
1398	10354	1699	Ali Dervishi	ME BURG	1492	11355	1699	Syrja Golja	ME BURG				Kristofor Kallapodhi	KAPITAL
1399	10359	1699	Mahmut Toçi	ME BURG	1493	11380	784	Elmas Noka	ME BURG	1589	12757	784	Muharrem Iljazi	ME BURG
1400	10360	707	Ramadan Kurti	ME BURG	1494	11383	784	Mark Gjergji	ME BURG	1590	12762	784	Jakup Babaliu	ME BURG
1401	10367	707	Pasha Bimi	ME BURG	1495	11389	1699	Alfonas Beqari	ME BURG	1591	12766	1699	Avdyll Kalbaj	ME BURG
1402	10371	707	Nikoll Rraxhburgaj	ME BURG	1496	11393	707	Vasil Dhaskali	ME BURG	1592	12815	784	Sabri Ndreu	ME BURG
1403	10386	707	Marash Lecaj	ME BURG	1497	11401	707	Nebi Meto	ME BURG	1593	12828	1699	Jonuz Sharra	ME BURG
1404	10416	1699	Haki Pengili	DENIM	1498	11403	1699	Isuf Nika	ME BURG	1594	12832	1231	Thanas Naçi	ME BURG
				KAPITAL	1499	11412	1699	Xhafer Kondi	ME BURG	1595	12841	784	Emin Gjura	DENIM
1405	10417	707	Tahir Demi	DENIM	1500	11430	1699	Istref Hoti	ME BURG	1596	12859	784	Frane Doçi	ME BURG
				KAPITAL	1501	11444	707	Demush Mulaj	ME BURG				Xhaferr Zotaj	ME BURG
1406	10420	707	Natalia Pengili	ME BURG	1502	11458	707	Xhemil Pajo	ME BURG	1597	12862	784	Nuri Dymishi	ME BURG
1407	10460	707	Pasho Bashaj	ME BURG	1503	11478	784	Mustafa Harizi	ME BURG	1598	12870	707	Petro Hodbardi	ME BURG
1408	10472	1699	Karolin Shala	ME BURG	1504	11503	707	Syrja Peshkopia	ME BURG	1599	12880	707	Dule Banushi	ME BURG
1409	10474	707	Selim Pone	ME BURG	1505	11504	784	Dashnor Mamaqi	ME BURG	1600	12883	784	Fane Kallushi	ME BURG
1410	10479	707	Mehmet Gjeta	ME BURG	1506	11547	707	Kundret Kurti	ME BURG	1601	12886	707	Rexhep Meta	ME BURG
1411	10480	1699	Basri Kadilli	ME BURG	1507	11548	784	Namik Zenelaj	ME BURG	1602	12902	784	Napolon Kaleci	ME BURG
1412	10489	1699	Skënder Shtylla	ME BURG	1508	11554	784	Kita Bello	ME BURG	1603	12935	707	Jahja Kurti	ME BURG
1413	10503	1699	Fuat Malko	ME BURG	1509	11565	707	Pjeter Palaj	DENIM	1604	12976	784	Andon Kolaci	ME BURG
1414	10504	1699	Simon Boba	ME BURG					KAPITAL	1605	13031	1231	Burim Kokoshi	ME BURG
1415	10518	1699	Petrit Koka	ME BURG	1510	11566	707	Avduraman Kreshpa	ME BURG	1606	13071	784	Shyqyri Bushati	ME BURG
1416	10547	1699	Leka Dosti	ME BURG	1511	11567	707	Sami Koprencka	ME BURG	1607	13094	784	Eljaz Troshani	ME BURG
1417	10558	1699	Muharrem Vogli	ME BURG	1512	11590	1147	Hajro Babameto	ME BURG	1608	13137	784	Kolë Prela	ME BURG
1418	10592	707	Kol Piroli	ME BURG	1513	11602	707	Aleksander Cico	ME BURG	1609	13142	707	Zane Bajrami	ME BURG
1419	10593	1699	Ilo Arqjendi	ME BURG	1514	11611	784	Maliq Petrela	ME BURG	1610	13143	784	Emërör Kaleci	ME BURG
1420	10600	1699	Ilmi Braçellari	ME BURG	1515	11614	707	Mexhit Asllani	DENIM	1611	13201	784	Kristaq Cervishi	ME BURG
1421	10609	1699	Agim Dobruna	ME BURG					KAPITAL	1612	13208	784	Shaqir Sata	ME BURG
1422	10634	707	Protoko Murataj	ME BURG	1516	11626	1699	Arshim Laraku	ME BURG	1613	13225	707	Prek Tusha	ME BURG
1423	10636	784	Islam Lamçaj	DENIM	1517	11644	784	Kol Kostara	ME BURG	1614	13247	784	Ram Tusha	ME BURG
				KAPITAL	1518	11663	707	Radomir Xhudoqi	ME BURG	1615	13254	784	Nase Alihxhaj	ME BURG
1424	10639	707	Xhevat Xhidra	ME BURG	1519	11666	784	Halit Marku	ME BURG	1616	13258	784	Mihal Giovasho	ME BURG
1425	10642	784	Arif Sokoli	ME BURG	1520	11676	1699	Islam Seferi	ME BURG	1617	13331	784	Abdurahman Dibra	ME BURG
1426	10646	707	Dino Noga	ME BURG	1521	11678	707	Veisel Hasrama	ME BURG	1618	13341	784	Zilfo Daci	ME BURG
1427	10651	707	Paulin Shestani	DENIM	1522	11700	707	Pjeter Milaj	ME BURG	1619	13386	784	Riza Çakëri	ME BURG
				KAPITAL	1523	11705	707	Eshref Shameti	ME BURG	1620	13388	784	Nikolla Mborja	ME BURG
1428	10656	1699	Gaço Dishnica	ME BURG	1524	11728	784	Refat Vishkulli	ME BURG	1621	13390	784	Bajram Hoxha	ME BURG
1429	10704	1699	Tomor Gjergjani	ME BURG	1525	11744	1147	Andrea Petroviq	ME BURG	1622	13409	784	Ferit Perxizi	ME BURG
1430	10705	784	Sali Mako	ME BURG	1526	11756	784	Vangjel Zaharia	ME BURG	1623	13420	784	Anton Dukagjini	ME BURG
1431	10708	1699	Gjenaro Daberdaku	ME BURG	1527	11760	1699	Hasan Zaimi	ME BURG	1624	13432	707	Nevruz Bejleri	DENIM
1432	10709	1699	Isa Molla	ME BURG	1528	11799	707	Besim Xhydollari	ME BURG	1625	13444	784		KAPITAL
1433	10714	707	Petro Tomori	ME BURG	1529	11839	784	Vangjel Cini	ME BURG	1626	13466	784	Çup Porja	ME BURG
1434	10721	784	Pashuk Tusha	ME BURG	1530	11914	784	Nikoll Marku	ME BURG				Baftjar Kerçaku	ME BURG
1435	10739	1699	Mark Gera	ME BURG	1531	11919	784	Aleksander Daberdaku	ME BURG	1627	13468	784	Ahmet Cobo	ME BURG
1436	10756	1699	Mehdi Qyteza	ME BURG	1532	11939	784	Mhill Noka	ME BURG	1628	13495	1147	Vasel Rushaj	ME BURG
1437	10758	1699	Qazim Konica	ME BURG	1533	11945	707	Telat Mehmeti	ME BURG	1629	13506	784	Xhemal Kopaçi	ME BURG
1438	10766	1699	Salim Prifti	ME BURG	1534	11960	1147	Tanush Frashëri	ME BURG	1630	13508	707	Nazmi Mesut	ME BURG
1439	10769	707	Reshat Qafzezi	DENIM	1535	11961	1699	Enver Meda	ME BURG	1631	13569	784	Sefedin Skenderi	ME BURG
				KAPITAL	1536	11974	784	Zef Gjonaj	ME BURG	1632	13685	784	Ali Rrushli (Ademi)	ME BURG
1440	10771	707	Aleks Karablini	ME BURG	1537	12002	707	Koço Zguri	ME BURG	1633	13745	784	Tahir Hoxha	ME BURG
1441	10782	707	Frok Sadiku	ME BURG	1538	12061	1259	Asim Golemi	ME BURG	1634	13794	784	Koço Theodhosi	DENIM
1442	10784	707	Aziz Kaloshi	DENIM	1539	12068	784	Luc Kokaj	ME BURG	1635	13812	784		KAPITAL
				KAPITAL	1540	12071	784	Agron Çomo	ME BURG	1636	13822	784	Aristotel Papaj	ME BURG
1443	10813	784	Islam Bami	ME BURG	1541	12078	1699	Leka Toto	ME BURG				Egerem Hoxha	ME BURG
1444	10817	1699	Hamza Shehu	ME BURG	1542	12109	784	Halit Laci	ME BURG	1637	13875	784	Nikoll Gurraj	ME BURG
1445	10839	1699	Abdulla Sinani	ME BURG	1543	12132	784	Kristo Xexo	ME BURG	1638	13883	1231	Sali Martinaj	ME BURG
1446	10842	1699	Adem Meniku	ME BURG	1544	12134	1147	Hasan Billosmi	ME BURG	1639	13898	784	Imer Ndrejoni	ME BURG
1447	10850	784	Rexhep Bulku	ME BURG	1545	12144	784	Spiro Disho	ME BURG	1640	13982	784	Hamza Cungu	ME BURG
1448	10858	707	Andrea Gjini	ME BURG	1546	12151	784	Cake Hysaj (Ponari)	ME BURG	1641	13987	1147	Sabri Gjogjega	ME BURG
1449	10871	1231	Besnik Duro	ME BURG	1547	12160	707	Bajram Nezaj	ME BURG	1642	14006	1231	Xhemil Demiraj	ME BURG
1450	10872	1699	Llazaraj Ruço	ME BURG	1548	12170	707	Xheahir Turani	ME BURG	1643	14029	784	Vilgelmina Veshi	ME BURG
1451	10880	1699	Qamil Çota	ME BURG	1549	12193	784	Jakup Cerriku	ME BURG	1644	14160	784	Angjelin (Ejll) Çoba	ME BURG
1452	10881	1699	Shefqet Alla	ME BURG	1550	12223	1147	Seit Shabani	ME BURG	1645	14161	784	Mikel Çoba	ME BURG
1453	10895	1699	Qamil Belba	ME BURG	1551	12245	707	Vangjel Xhomaka	ME BURG	1646	14170	784	Apollot Gjata	ME BURG
1454	10902	1259	Selami Deliallisi	ME BURG	1552	12259	707	Zef Preka	DENIM	1647	14171	784	Aleks Balla	ME BURG
1455	10906	1147	Mintas Kanina	ME BURG					KAPITAL	1648	14195	784	Ibrahim Selenica	ME BURG
1456	10959	1231	Xhevit Zalosnjha	ME BURG	1553	12264	784	Gjok Tosku	DENIM	1649	14197	784	Ventigjar Hamzaraj	ME BURG
1457	10965	784	Qemal Jasxhi	ME BURG					KAPITAL	1650	14272	784	Hito Lamaj	ME BURG
1458	10981	1259	Eqrem (Eqerem) Agolli	ME BURG	1554	12322	707	Pandi Gusho	ME BURG	1651	14273	784	Baftjar Çausi	ME BURG
				BURG	1555	12323	707	Xhemal Kalo	ME BURG	1652	14297	707	Shaqir Kaloshi	ME BURG
1459	10986	1699	Sali Guri	DENIM	1556	12326	707	Zef Kukaj	ME BURG	1653	14298	1147	Kol Kiri	ME BURG
				KAPITAL	1557	12337	707	Qemal Baçe (Hyseni)	ME BURG	1654	14305	784	Jani Fili	ME BURG
1460	10992	784	Pajazit Kaloshi	ME BURG	1558	12341	784	Muharrem Kamberi	ME BURG	1655	14429	784	Qemal Xhyheri	DENIM
1461	10993	707	Mehdi Muda	ME BURG	1559	12343	784	Qeramedin Stermasi	ME BURG	1656	14430	784		KAPITAL
1462	11005	707	Fadil Uba	ME BURG	1560	12349	1259	Pal Marashi	ME BURG	1657	14435	784	Halil Hidri	ME BURG
1463	11011	707	Hasan Smajli	ME BURG	1561	12375	707	Husam Selfo	ME BURG	1658	14437	784	Mark Kalaj	ME BURG
1464	11016	1699	Ramiz Kaca	ME BURG	1562	12376	707	Ramadan Azisllari	ME BURG	1659	14438	784	Qamil Peni	ME BURG
1465	11017	1699	Asti Hobdari	ME BURG	1563	12380	784	Simon Rushaj	ME BURG	1660	14439	784	Qeram Guri	ME BURG
1466	11019	1699	Bib Nikolli	ME BURG	1564	12405	707	Bexhet Gedaj	ME BURG	1661	14440	784	Argjent Goci	ME BURG
1467	11021	1699	Selim Skajoti	ME BURG	1565	12426	784	Nikë Ujkaj	ME BURG	1662	14441	784	Shaban Aloili	ME BURG
1468	11030	1259	Sinan Petrela	ME BURG	1566	12453	784	Ali Muja	ME BURG	1663	14442	784	Adem Malaj	ME BURG
1469	11041	707	Zef Deda	ME BURG	1567	12472	784	Inna Shahe	ME BURG	1664	14443	784	Muharrem Shala	ME BURG
1470	11050	1699	Kozma Dadolli	ME BURG	1568	12478	1259	Reuf Uruçi	ME BURG	1665	14444	784	Ferit Zaimi	ME BURG
1471	11084	784	Ihsan Libohova	ME BURG	1569	12487	1699	Njazi Zaçe	ME BURG	1666	14445	784	Egerem Hado	ME BURG
1472	11085	1699	Skender Mersini	ME BURG	1570	12488	1147	Imer Bardhoshi	ME BURG	1667	14446	784	Sali Nelaj	ME BURG
1473	11119	707	Hasan Graceni	ME BURG	1571	12493	707	Muharrem Kasmi	ME BURG	1668	14447	784	Perparim Kajmaku	ME BURG
1474	11122	707	Avdi Golja	ME BURG	1572	12498	1699	Shaban Gashi	ME BURG	1669	14448	784	Kiço Ngjela	ME BURG
1475	11143	707	Behar Polovina	ME BURG	1573	12506	784	Pjeter Lleshaj	ME BURG	1670	14449	784	Agathokli Xhitomi	DENIM
1476	11145	784	Riza Kamjeri (Kuçi)	ME BURG	1574	12520	707	Jorgji Robo	ME BURG	1671	14450	784		KAPITAL
1477	11158	784	Mustafa Greblleshi	ME BURG	1575	12580	784	Tomor Ypi	ME BURG	1672	14451	784	Ali Fortuzi	ME BURG
1478	11172	1699	Marko Katro	ME BURG	1576	12606	784	Abaz Deliallisi	ME BURG	1673	14452	784	Sherif Largu	

Opinion *i* Ditës

# 5 për qind e PBB përkrahje për arsimin, pse s'u mbajt premtimi?

Nga Shezai Rrokaj

(vijen nga faqja 1)

... IAL-të dhe i miratonte qeveria, kurse me këtë ligj ajo lau duart duke ualënë në derë përgjegjësinë universiteteve. Por përse më parë ajo nuk i uli tarifën? Përse nuk shprehet sa është tavan dhe dys-hemeja e tarifave sikundër ligji e kërkon? Përse nuk i subvencionon sipas standardeve të njohura IAL-të? Kjo ndodh sepse qeveria nuk mbështet arsimin me 5% të PBB-së, siç premtoi në vitin 2014. Ndryshe nga vendet e OECD-së, dhe gjithë rajoni, buxheti për arsimin është vetëm 3,2%. Kurse universitetet mbështeten vetëm me 0,5% të PBB-së.

Me këto fonde nuk mbulohen as 12 muaj paga. Ndërkaq, vetëm me paratë e 2 km rrugë, si ajo e Unazës së Re, tarifën barazohen me ato të rajonit. Kjo është arsyeja kryesore e tarifave të larta dhe pagave më të ulëta në rajon për



pedagogët. Mungojnë fondet për kërkim dhe bibliotekat 'online' për studentët dhe pedagogët. Që prej Amerikës e Evropës, me në krye

Finlandën, investimi për arsimin shkon në 7% të PBB-ve të tyre, sepse kudo është kuptuar se investimi në kapitalin njerëzor është

më dobiprurës se çdo investim tjetër. Krejt ndryshe, qeveritë shqiptare kanë ndjekur politika demotivuese, deri në frenuese, sepse

asnjëherë bota akademike nuk është parë si partner zhvillimi. Madje, pushteti politik e ka parë me një smirë e xhelozizë bizantine,



## REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

### SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rrvlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit".

#### 1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

#### KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime në fushën IT.
- Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

#### KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

#### 2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

#### KËRKESA TË POSAÇME TË POZICIONIT "PËRKTHYES":

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

#### KUSHTET PËR GJITHSHME PËR VENDET VAKANTE "SPECIALIST IT" DHE "PËRKTHYES"

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 12 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose



Opinion

i Ditës

# Konflikti global, në një epokë të re të ekstremeve

Shlomo Ben-Ami

(vijon nga faqja 1)

... e çoi në depresione ciklike; ndërsa nacionalizmi e zhyti në dy luftëra botërore.

Ai më pas parashikoi, se e ardhmja do të përbënte një zgjatim të së kaluarës dhe të tashmës, e karakterizuar nga "politika dhe ndryshime të dhunshme politike", si dhe nga "shpërndarja sociale, dhe jo rritja ekonomike". Historia mund të mos përsëritet, por ajo shpesh rimon.

Pretendimi i famshëm i kryemnistres britanike Margaret Thatcher se "nuk ekziston shoqëria", por vetëm "burra dhe gra individualisht", rimon me siguri me botëuptimin përcarës dhe sjelljen vetë-shërbyese të demagogëve populiste të sotëm.

Sot, ashtu si në shekullin XX, nacionalizmi është duke përcarë më tej shoqëritë e ndara, duke ndarë aleatët e vjetër, duke nxitur antagonizmin ndaj "tjetrit", dhe duke justifikuar barrierat proteksioniste fizike dhe ligjore. Fuqitë e mëdha të botës, kanë rimarrë qëndrimet e Luftës së Ftohtë, duke u përgatitur psikologjikisht, në mos ushtarakisht, për një konflikt të hapur.

Sikurse e parashikoi Hobbsaun, rritja e pabarazisë së të ardhurave, është shfaqur si një shkak kryesor i rritjes së nacionalizmit, ndjenjës anti-globalizmit, dhe madje edhe i zhvendosjes drejt autoritarizmit. Duke rikontfirmuar lidhjen mes ekonomisë së keqe dhe ekstremizmit politik - të theksuar nga Xhon Mejnard Keynes pas Luftës së Parë Botërore - një dekadë masash shtrënguese në Evropë, i ka dobësuar themelet e shtetit social, dhe ka hedhur miliona votues në krahët e populistëve.

Ironikisht, arsyeja kryesore se përse politika e sotme, po i ngjason gjithnjë e më shumë me zhvillimeve të shekullit të XX-të, është frika e përsëritjes së Depresionit të Madh - një frikë që u shfaq pas krizës financiare të vitit 2008, dhe që u duk se po rimonte me rrëzimin e tregut të aksioneve në vitin 1929.

Për shembull, Gjermania, u bë e fiksuar pas masave shtrënguese, në mënyrë që të sigurohej që inflacioni i madh të mos çonte në rrënimin e një vendi në diktaturë, siç kishte ndodhur në vitet 1920. Por masat shtrënguese shkuan aq larg, sa që i dhanë mundësi politikaneve anti-establishment të përfitojnë nga vështirësitë ekonomike, për të fituar mbështetje elektorale.

Në përpjekje për të vijuar të jenë konkurruese në zgjedhje, shumë parti të establishmentit u larguan nga qendra, duke bërë që e gjithë fusha politike të bëhej



gjithnjë e më shumë e polarizuar.

Kjo prirje, mund të shihet në Shtetet e Bashkuara, ku një udhëheqjen e Presidentit Donald Trump, Partia Republikane ka mbetur praktikisht pa asnjë zë të moderuar. Kjo gjithashtu mund të shihet në Mbretërinë e Bashkuar, ku një Partisë Laburiste gjithnjë e më radikale nën udhëheqjen e Xheremi Korbini, po përballlet me një Parti Konservatore të mbajtur peng nga ekstremistët pro-Brexit.

Në Itali, Lëvizja populiste Pesë Yjet dhe Lidhja nacionaliste, janë bashkuar në një koalicion qeverisës, pas rënies që pësuan forcat politike kryesore të vendit në zgjedhjet e marsit.

Kur kryeministri italian, Xhuzeppe Konte i tha Vladimir Putin se Rusia është "partneri strategjik" i Italisë, u bë e qartë se Italia, një anëtare kryesore e BE-së dhe NATO, ishte shndërruar në një vend potencialisht destabilizues.

Në Spanjë, Partia Popullore, është bërë haptazi nacionaliste nën udhëheqjen e liderit të linjës së ashpër Pablo Kasado. Partia Socialiste e Punëtorëve Spanjollë e kryeministrit Pedro Sanchez, është imazhi pasqyruar i Partisë Popullore, duke e braktisur trashëgiminë centriste të Felipe Gonzalezit, në mënyrë që të konkurrojnë me populistët e majtë të Podemos.

Në Gjermani, votuesit në Bavari dhe Hesen e braktisën Union Kristiandemokrat të qendrës së djathtë të Kancelares gjermane Angela Merkel, dhe partinë e saj motër, Unionin Kristiansocial. Të Gjelbrit tërhoqën vota nga Partia Socialdemokrate më e moderuar, dhe Alternativa për Gjermaninë e ekstremit të djathtë, fitoi goxha terren.

Me qendrën e rrudhur ndjeshëm, kapaciteti i Gjermanisë për të mbetur në pararojë të një

Europe të bashkuar, është në rrezik. Edhe koncepti që një udhëheqës radikal - madje neofashist - të mund të sundojë një ditë në Gjermani, nuk duket më i largët.

Ndërsa demokracitë e braktisin moderimin, po rriten shpërdorimet e pushtetit dhe tensionet shoqërore dhe politike. Në SHBA, Trump i demonizon vazhdimisht kundërshtarët, dhe de-humanizon grupet e marginalizuara. Gjatë vitit të tij të parë në detyrë, vrasjet për motive politike, të kryera kryesisht nga supremacistët fanatikë të bardhë, u dyfishuan.

Rreziqet që dalin nga këto zhvillime, vështirë se kufizohen vetëm në vendet në fjalë. Ruajtja e paqes relative globale - ose të paktën shmangia e luftërave të mëdha ndërshtetërore - varet nga aleancat të forta, dhe ndërgjegjësimi i udhëheqësve për shkatërrimin e armëve të tyre.

Por, në një kohë kur figura radikale dhe të papërvojta po ngjiten në pushtet, të dy këto shtylla kundër luftës janë dobësuar. Në fakt, kuadri i paqes globale tashmë po vihet nën një presion në rritje. Për shkak të revanshizmit të pamëshirshëm të presidentit rus Vladimir Putin, kufijtë e Rusisë me NATO-n, janë shndërruar aktualisht në vendet e dislokimit më të madh ushtarak që nga Lufta e Ftohtë.

Si për t'i përkëqësuar gjërat më tej, Trump ka tërhequr Shtetet e Bashkuara nga Traktati i Forcave Bërthamore me Reze të Mesme, duke hedhur në erë dekadë të parimit në kontrollin e armëve bërthamore. Ai duket se shpreson ta detyrojë Rusinë (dhe Kinën), për nënshkrimin e një marrëveshjeje të re, duke kërcënuar me "zhvillimin e armëve".

Por ai nuk ka gjasa që të ketë sukses. Ndërsa Ronald Reagan,

ishte duke negociuar me reformatorin Mikhail Gorbaçov, Trump do të përballlet me Putinin e uritur për pushtet. Rreziqet me të cilat ballafaqohen bota, janë të komplikuar edhe nga teknologjitë e reja dhe jo të mirë-disiplinuara. Lufta kibernetike, është tashmë një realitet i përditshëm.

Në fakt, në çdo moment, një sulm kibernetik mund të nisë kundër një vendi të NATO-s, duke aktivizuar potencialisht garancinë e mbrojtjes së ndërsjellë të aleancës. Po kështu, Kombet e Bashkuara, nuk kanë arritur deri më tani të kapërcejnë kundërshtimin ndaj rregullimit të përdorimit të armëve autonome vdekjeprurëse, bazuar në inteligjencën artificiale.

Rreziku i një konflikti të dhunshëm, do të vazhdojë të rritet, pasi të intensifikohen efektet e ndryshimeve klimatike. Ndër të tjera, shkretëtirizimi masiv në Lindjen e Mesme dhe Afrikë, do të sillte zi buke, që do të linin në hije edhe zité famëkeqe të bukës në shekullin XX-të. Emigracioni i njerëzve do të shtohet, dhe lufta për burimet natyrore do të përshkallëzohet.

Me gjithë përpjekjet për të siguruar një bashkëpunim shumëpalësh, në botën e sotme Hobe-siane, rrëshqitja drejt një klime kaotike duket e pandalshme.

Sfidat me të cilat ballafaqohet bota sot, do të ishin të paimagjinueshme në shekullin XX. Por dinamika politike themelore, është shumë e njohur. Është koha që të vlerësojmë, se cilat janë ato sjellje dinamike, dhe të marrim seriozisht parasysh leksionet që na ka mësuar historia.

Shënim: Shlomo Ben-Ami, ish-ministër i Jashtëm i Izraelit. Aktualisht është zv/drejtor i Qendrës Ndërkombëtare të Paqes Toledos.

"Project Syndicate" - Bota.al

## HOROSKOPI

### DASHI

Do të kërkonti të arrini rezultate mbresëlënëse. Gjatë ditës fati juaj mund të ndryshojë shumë dhe bëhet fjalë për ndryshime pozitive. Ka gjasa t'ju kthehet një mik i ngushtë. Në aspektin personal, diçka shumë e këndshme do të ndodhë.

### DEMI

Mos u tregoni të dobët përballë disa vështirësive të përkohshme. Këto probleme do të zhduken shumë shpejt dhe do të ndihni sërish të lumtur. Gjatë pjesës së parë të ditës do ndihni shumë nervozë, megjithatë bëni mirë të shpërlini fjalët e disa personave që nuk ju bëjnë të ndihni mirë.

### BINJAKET

Do të keni sukses në romancë. Nëse keni debatuar kohët e fundit me partnerin/partnerin tuaj, sot ka gjasa që të pajtoheni. Disa persona të kësaj shenje mund të jenë në kërkim të dashurisë së vërtetë. Dëgjoni zemrën dhe ajo do t'ju sinjalizojë se ku të gjeni gjysmën tuaj perfekte.

### GAFORJA

Do të ndihni shumë mirë gjatë ditës së sotme. Bëni mirë të jeni optimistë, pasi vetëm kështu mund të arrini sukses në jetën tuaj profesionale dhe personale. Është e rëndësishme që të vendosni se çfarë keni prioritet dhe të besoni në vetvetë.

### LUANI

Personat e kësaj shenje këshillohen ta kalojnë këtë ditë, duke shijuar ato çfarë kanë arritur. Ka gjasa që të arrini sukses edhe në një fushë me të cilën nuk jeni hasur më parë. Sa i përket aspektit personal, nuk do të ketë ndryshime.

### VIRGJERESHA

Do ta kaloni ditën duke menduar për të shkuarën. Do të mërziteni teksa do të kujtoni një dëshim në aspektin personal. Përpjoni që të mos qëndroni tek ato kujtime dhe të ecni përpara, pasi kështu mund të shkatërroni ditën.

### PESHORJA

Nuk do të jetë e nevojshme t'i vërtetoni çdo gjë dikujt. Çfarë problemi ka nëse jo të gjithë e vlerësojnë dinjitetin tuaj? E rëndësishme është që të vlerësoheni nga familja, miqtë dhe persona të tjerë të afërt.

### AKREPI

Duhet të analizoni sërish marrëdhëniet tuaja me persona të seksit të kundërt. Duhet të mendoni nëse ka respekt, besim apo dashuri nga ana e partnerit/partneres suaj. Ndërsa personat e shenjës së akrepit që janë beqarë, duhet të punojnë më shumë për të kuptuar veten.

### SHIGJETARI

Disa Shigjetarë do ta shpenzojnë ditën nën hijen e dyshimit. Kjo ka të bëjë me të shumti me të ardhmen tuaj. Pyesni familjarët tuaj se çfarë mendojnë lidhur me këtë çështje. Por mund të mbështeteni edhe tek intuija juaj.

### BRICJAPI

Mund të merrni një dhuratë të madhe. Ka gjasa të mos impresionoheni por bëni mirë t'i fshihni emocionet. Do të përballeni me disa situata të sikletshme si në familje, ashtu edhe në punë. Shmangni personat, të cilëve nuk iu kuptohet qëndrimi.

### UJORI

Ujorët nuk duhet të ndjekin këshillën e askujt sot. Mbajeni vetë jetën tuaj nën kontroll dhe përpjoni të ndiqni kursin e duhur. Mos ngrii dyshime dhe duhet të keni sa më shumë besim tek vetvetja.

### PESHQIT

Mund të ndihni shumë mirë psikologjikisht sot. Megjithatë, mos u shqetësoni. Një sërë problemesh me të cilat jeni përballur do të përfundojnë shumë shpejt. Do të kaloni të qetë nën shoqërinë e partnerit/partneres suaj.



## Shpërthen cisterna në Itali, 2 të vdekur e 17 të plagosur

Dy të vdekur dhe 17 të plagosur është bilanci i një incidenti të rëndë të ndodhur pasditen e djeshme rreth orës 14:30 pranë Borgo Quinzio në Rieti, në rrugën Salaria. Një cisternë e mbushur

me lëndë të djegshme ka shpërthyer brenda stacionit të shërbimit duke shkaktuar një zjarr masiv. Sipas informacioneve të para, mes të plagosurve janë dhe punonjësit të ndihmës së shpejtë si dhe 7 zjarrfikës.

Një prej viktimave raportohet se është zjarrfikës. Shpërthimi dyshohet se ka ndodhur gjatë operacioneve të shkarkimit të karburantit. Shpërthimi ndodhi në depoizitën e dytë të zonës së shërbimit ku zjar-

rfikësit ishin duke punuar për të shuar flakët e shpërthimit të depoizitës së parë. Forcat e rendit kanë bllokuar rrugën në të dyja drejtimet dhe në vend përveç disa skuadra të zjarrfikësve, kanë ndërhyrë edhe forcat e 118-ës.


Këshilli i Ministrave i BE shtyu diskutimin e çështjes për në 6-7 dhjetor

## Liberalizimi i vizave për Kosovën, 22 eurodeputetë letër Tuskut: Jo më shtyrje

*Engel: Mosliberalizimi është tradhti e premtimeve të BE-së*



Këshilli evropian




## Ushtria e Kosovës, Moska: Krijon pasoja serioze në Ballkan

Formimi i ushtrisë së Kosovës ka patur reagim edhe nga Moska. Ajo ka thënë se mund të ketë pasoja serioze për sigurinë në Ballkan. Ministria e Punëve të Jashtme e Rusisë vlerëson se "një hap i tillë mund të jetë shkelja më e rëndë direkte e Rezolutës 1244 e OKB-së". Ky është edhe një hap provokues dhe destabilizues pas vendosjes së takës prej 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja", thuhet në komunikatën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, shkruan KP. "Ushtria mund të sjell pasoja të rënda jo vetëm për banorët serbë, por edhe sigurinë e Ballkanit në tërësi". Nga Moska shpresojnë se forcat ndërkombëtare që janë në Kosovë do t'i përbahen mandatin që kanë dhe një rast të "paralajmërimit të strukturave të tilla menjëherë do të marrin masa për neutralizimin e tyre dhe çarmatimin".



## Kryeministrja serbe: Shpresojmë të mos përdorim ushtrinë tonë

Ana Brnabić, kryeministria e Serbisë, ka thënë se shpreson se Serbia nuk do të duhet të përdorë ushtrinë e saj, pas formimit të paralajmëruar të ushtrisë së Kosovës. "Shpresoj se nuk do të kemi nevojë kurrë të përdorim ushtrinë, por, në këtë moment, një gjë e tillë është një nga opsionet në tryezë, sepse nuk mund të shohim pastrim të ri etnik dhe stuhi të reja, edhe pse "kryeministri i Shqipërisë" Edi Rama bën thirrje për të tilla", tha Brnabić për gazetaret në Qeverinë e Serbisë, raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropë e Lirë. Brnabić nuk e sqaroi se ku dhe kur i ka bërë Rama këto komente. Autoritetet e Kosovës kanë paralajmëruar se, më 14 dhjetor, Kuvendi i Kosovës do t'i votojë projektligjet që e transformojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës në forcë me kapacitete ushtarake.



Një grup prej 22 deputetësh të Parlamentit Evropian kanë kërkuar ditën e martë që Kosovës t'i jepet liberalizimi i vizave pa shtyrje. Në një letër drejtuar presidentit të Këshillit Evropian, Donald Tusk dhe presidentes austriake të Bashkimit Evropian, deputetët shkruajnë se liberalizimi i vizave do të përmirësojë qëndrueshmërinë dhe do ta afrojë Kosovën me Bashkimin Evropian. Duke theksuar se Kosova është i vetmi vend i papërfshirë në këtë regjim, deputetët shkruajnë se kjo krijon ndjenjë të izolimit që ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve të Kosovës. Në letër përmendet fakti se Komisioni Evropian që më 18 korrik kishte pohuar se Kosova i ka përmbyshur kriteret për përfshirje në këtë regjim dhe Parlamentit Evropian me shumicë votash më 13 shtator mbështeti liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Propozimi i parë nga Komisioni Evropian që dhënë në maj të vitit 2016, por procesi i u bllokua për shkak të mosratifikimit të marrëveshjes për shënimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Pas gati tri vjet debatesh e përplasjesh në parlamentin e Kosovës, por edhe jashtë tij, marrëveshja u ratifikua në mars të këtij viti. Në Kosovë kishte shpresë se këtë muaj Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian do ta diskutonte këtë çështje në takimin e 6 dhe 7 dhjetorit, por kjo nuk është përfshirë në agjendën e takimit. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës së komisionarit të BE-së për zgjerim, Johannes Hahn, i cili të hënën qëndroi në Kosovë për të nxitur Prishtinën që të heqë tarifat prej 100 për qind ndaj mallrave nga Serbia. Ligjvënësi amerikan Eliot Engel, i bërë jehonë letrës së deputetëve të Parlamentit Evropian që besojnë se është thelbësore që Kosovës t'i jepet liberalizimi i vizave. "Jam i zhgënjyer nga komisionari i BE-së, Johannes Hahn, i cili tha se liberalizimi i vizave për Kosovën do të shtyhet sërisht. Kosova ka bërë krejt çfarë ka kërkuar Bashkimin Evropian. Mohimi i liberalizimit të vizave është tradhti e premtimeve që ka bërë Bashkimi Evropian", shkroi ai. Qytetarët e Kosovës aktualisht janë të vetmit në rajonin e Ballkanit perëndimor që duhet të kërkojnë vizë për të udhëtuar në vendet e Bashkimit Evropian,

ndërsa qytetarët e vendeve fqinje vitin e ardhshëm mbushin dhjetë vjet që kur janë përfshirë në regjimin e udhëtimit pa vizë. Nga ana tjetër, senatori republikan Eliot Engel deklaroi se ndihet i zhgënjyer nga politika e de-

ritanishme e komisionarit të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn. Ky i fundit deklaroi se liberalizimi i vizave për Kosovën është shtyrë deri në vitin 2020. Përmes një postimi në Twitter Engel tha se Kosova ka

bërë çdo gjë që i ka kërkuar BE-ja lidhur me kushtet për liberalizim. Mes të tjerash ai shtoi se refuzimi i liberalizimit të vizave është tradhti e premtimeve që ka bërë BE-ja. "I zhgënjyer nga komisionari i BE-së, Johannes Hahn që

thas liberalizimi i vizave për Kosovën do të shtyhet përsëri. Kosova ka bërë çdo gjë që i është kërkuar nga BE-ja. Refuzimi i liberalizimit të vizave është tradhti e premtimeve që ka bërë BE-ja", shkruan Engel.


### SHKURT

#### Për azil në Hungari, 30 ditë burg për Grueskin

Ditën e djeshme gjykata e Shkupit ka caktuar masën 30 ditë burg për ish-kryeministrin maqedonas Nikolla Grueski ndërkajshëm kryeministri ndodhet për azil politik në Hungari. Në seancën e djeshme për rastin "Titanik", gjykata me kërkesë të PPS, caktoi paraburgim prej 30 ditësh për Grueskin, i cili është në arrati. Ky është paraburgimi i dytë për Grueskin në mungesë. Para tetë ditëve gjykata i shqiptoi paraburgim edhe për rastin "Talir". Ndërkajshëm para arratisjes, ish-kryeministri maqedonas, u ka dërguar një letër kërre të BE-së. Letra është dërguar në adresë të Eurokomisionit për Zgjerim Johannes Hahn, përfaqësues për Politikë të Jashtme të BE-së Federica Mogherini, Komisarit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin Evropian, Dunja Mijatović dhe kryetarit të Partisë Popullore Evropiane, Joseff Doll. Grueski në letër shkruan se dënimin prej dy vitesh burg i është dhënë pa menduar se ka fakte të fabrikuar. Ai ka kërkuar që BE ose institucione tjera europiane të angazhojnë disa gjykatës të njohur nga vendet anëtare të BE-së që do të merren me akuzat kundër tij. Në letër Grueski ka prekur edhe një propozim tjetër, nëse i pari për Hahn, Mogherinin, Mijatovićin dhe Dollin nuk pranohet. Ai ka kërkuar që Bashkimi Evropian të dërgojë mision në Maqedoni. Nga ana tjetër, Maktel nga burimet në VMRO DPMNE dhe Ministrinë e Brendshme zbulon se ka të dhëna serioze se Grueski transferoi nga llogaritë e tij në Belize 50 milionë euro për Victor Orban për ta shpëtuar nga burg. Grueski ishte thyer mendërisht dhe nuk mund t'i lejonte njerëzit ta shihnin me prangë në një qeli pas 10 vjetësh qeverisjeje, ai do të vriste veten. Kështu që ai ishte i vendosur të jepte shumë nga pasuria e tij Orban për ta shpëtuar nga burg vazhdon më tej portali Maktel.



## Fjalëkryqi (1)



## HORIZONTAL

1. Parafjalë prejardhjeje.
3. I përshtatshëm.
7. Eshhtë sportive në garë.
11. Fidel që thirret Lider Maximo
13. Para Jack në flumirin britanik.
14. Rodrigues që këndonte fado.
16. Një pjesë e lartësisë.
18. Vende pa ne.
19. I është hequr të dënuarit.
20. Ishte miku i famshëm i Orestit.
22. Pak enigmatike.
23. Janë pasuri të investuara
25. Një pjesë e simpoziumit.
26. U përmbysën në Afganistan.
27. Inicialet e Moravia-s.
28. Ai B prek mëlinë.
29. Vritet në fund.
31. Manchester i Alex Ferguson.
33. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.

35. Eshhtë zëri... i hekurit.
37. Ai B është rezervë.
39. Shkroi Një jetë e Jezusit.
41. Eshhtë për medaljen e parë.
42. Papas aktore.
45. Thomson aktore.
47. Tri të parat në atletikë.
49. Kështu thirrej Marco Pantani.
50. Dhanë alarmin në kapitoll

## VERTIKAL

1. Bëhet në stacion.
2. Eshhtë irritimi.
3. Argento aktore.
4. Detarë pa erë.
5. Në krye të armatës.
6. Janë si meduza.
7. Mbeten në bisht.
8. Eshhtë gjendja e të martuarit.
9. Pesci aktor.
10. Kulmojnë në Akonkagua.
12. Një Baba përrallor.
13. Janë priftërinj
15. Më e pakta.
17. Rrëzon padinë një e tillë.
20. Ishin kalorësoit si Rolandi.
21. Poggi aktore.
23. Një mund të jetë republike.
24. Një material inert për çati.
26. Janë ushtarakë të ulët
28. Para parade në diskografi.
30. Trim pa çifte.
32. E ardhmja më e afër.
34. U vra në banjë nga Corday.
36. Një mund të jetë pushimi.
38. Një lloj njeriu.
40. Janë tek në numra.
43. Fund janari
44. Fillojnë nazet.
46. Mbyllin portat.
48. Nota e diapazonit.


## Fjalëkryqi (2)

## HORIZONTAL


1. Harris aktor.
3. Termocentrali i shkurtër.
5. Organizata me koska.
10. Një tufë bagëti.
12. Inicialet e Redford.
14. Kështu thonë se bëhet ai që mërzhitet.
15. Scarlet e Bashkë e erën.
17. Elvira aktore.
19. Eshhtë Panorama që ke në dorë.
21. Ushtojnë nga "ola".
22. Shtet aziatik.
24. Eshhtë ministri.
25. Në radhtë të parë.
26. G... për njerëzit e FBI.
27. Makina Micra.
31. Mund të jetë proteste.
32. Pasur pa kufij.
33. Gjika e Dora d'Istria.
36. Të fundit në dhjetor.

## VERTIKAL


1. Umberto që shkroi Baudolino.
2. Bertë këngëtare italiane.
3. Fillojnë një temë.
4. Një garë në hipodrom.
6. Qe burri i parë.
7. Një ndriçues.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. I dha fillin Tezetur.
10. Vihen për të mbyllur
11. Para Saint-Germain në futboll.
13. Qëllon në një vend.
16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
17. Janë përmasat.
18. Mbush në kufij.
20. I bëjnë duart me ar.
21. Inicialet e dali piktor.
23. Fillojnë argumentin.
28. Makina Ibiza.
29. Emri i Einstein.
30. Ndrriçojnë rrugët.
31. Kim që qe aktore.
32. I hedh i dorzuar.
34. Inicialet e Nolte aktor.
35. Ishin rapsodët e akejeve.
37. Fund shkurti.
40. Van der portier holandez.
44. Fillojnë masat
46. Inicialet e Rohmer.
47. Fillojnë teorikisht.
49. Numër i shkurtër.




## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

## SUDOKU

8	9		5			3		
1	5				6		2	
2					9	1		7
5			8			9	6	
	4	8	6	2				
	6				1			
		3	2				1	
	2			4		7	8	
	1	5		6				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	8	6	4	3	7	1	2	5
1	2	7	6	5	8	3	4	9
4	5	3	9	1	2	6	7	8
2	7	5	8	4	6	9	1	3
3	9	4	1	7	5	8	6	2
6	1	8	2	9	3	4	5	7
5	4	2	3	6	9	7	8	1
7	6	9	5	8	1	2	3	4
8	3	1	7	2	4	5	9	6

## Argëtim filozofik

"Nuk ka njeri aq frikacak që nuk mund të shndërrohet në hero për hir të dashurisë".

-Askush nuk mund të gënjëjë, askush nuk mund të fshehtë asgjë kur e shohin mend drejt në sy.

-Fjalët tona mund të fshehin mendimet tona, por veprimet tona i zbulojnë ato.

-Nëse më thua diçka, do ta harroj. Nëse më mëson diçka, do ta kujtoj. Nëse më jepni ndonjë përgjigje, do ta njoh. Shfaqësimi i një personi fajtor është gabim i drejtësisë. Dënim i një të pafajshmi, është krim.

-"Kushdo që njeh të tjerët ka njohuri, kushdo që e njeh veten ka mençuri".

## Thënie të mençura

- -Më mirë ferri këtu sesa në botën tjetër.
- -Shumica flejnë në këmbë, pak flejnë shtrirë!
- -Përvoja është emri që secili i jep gabimeve të tij
- -"Lumturia e njeriut simbolizohet nga numri 100. Një (1) është shëndeti, zero në vazhdim është pasuria dhe zeroja tjetër është lavdia".

## KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2
2	7	5			8	4	3	5	7	2
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5
12	5	13	5	10	1	7		6		13
2	7	18			5	11	2	6	5	8
8	2	6	2		2		1	8	5	11
1	6	8		17	9	5	7	2		9
3	1	5		8	2	16			2	7
2			3	2	6	5	9	2		13
6	2	7	2			3		7	18	6
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2

- -"Eshhtë më mirë të vdesësh në këmbë se të jetosh në gjunjë"
- -Çdo njeri është arkitekti i fatit të tij.
- -Ai që mund të durojë, veten mund të durojë gjithçka.



[www.gsh.al](http://www.gsh.al)  
GAZETA SHQIPTARE

# Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

Facebook: Gazeta Shqiptare  
Instagram: gazetashqiptare.al  
Twitter: Gazeta Shqiptare  
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com  
YouTube Youtube: Gazeta Shqiptare

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!



[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)